



The Forests Dialogue

**TFD STEERING COMMITTEE 2009**

**George Asher**  
Lake Taupo Forest Trust –  
New Zealand

**Marcus Colchester**  
Forest Peoples Programme

**Minnie Degawan**  
International Alliance of  
Indigenous and Tribal Peoples  
of the Tropical Forests

**Gerhard Dieterle**  
The World Bank

**Peter Gardiner**  
Mondi

**James Griffiths, TFD Co-Leader**  
World Business Council for  
Sustainable Development

**Jack Hurd**  
The Nature Conservancy

**Peter Kanowski**  
Australian National University

**Matti Karjula**  
Stora Enso

**Mikhail Karpachevskiy**  
Biodiversity Conservation Center –  
Russia

**Lars Laestadius**  
World Resources Institute

**Stewart Maginnis, TFD Co-Leader**  
International Union for the  
Conservation of Nature

**James Mayers**  
International Institute for  
Environment and Development  
(IIED)

**Colin McKenzie**  
Global Forest Partners

**Cassie Phillips**  
Weyerhaeuser Company

**Bob Ramsay**  
Building and Woodworkers  
International

**Carlos Roxo**  
Fibria

**Antti Sahi**  
Confederation of European  
Forest Owners (CEPF)

**Liz Sandler**  
American Forest Foundation

**Roberto Smeraldi**  
Amigos da Terra – Amazonia  
Brasileira

**Ken Strassner**  
Kimberly-Clark

**Rod Taylor**  
WWF International

**Justin Ward**  
Conservation International

**Emmanuel Ze Meka**  
International Tropical  
Timber Organization

**Gary Dunning, Executive Director**  
The Forests Dialogue

## The Forests Dialogue

# Investimet në pylltarinë lokale Në rajonin e Europës Jug-Lindore nga Makedonka Stojanovska<sup>1</sup>, Nenad Petrovic<sup>2</sup>, Atilla Lengyel<sup>3</sup>

Makedonka Stojanovska<sup>1</sup>, Nenad Petrovic<sup>2</sup>, Atilla Lengyel<sup>3</sup>

### 1: HYRJE

Ky informacion vjen nga linja që lidhen me dy organizata: Dialogu për Pyjet (TFD) dhe Konfederata Evropiane e Pronarëve të Pyjeve (CEPF), dhe është plotësuar nga kontributet kombëtare nga Maqedonia dhe Serbia.

Që nga 2002, TFD ka hartuar dhe zhvilluar mbi 25 dialogë politikë mbi çështje të ndryshme thelbësore mbi ruajtjen e pyjeve dhe pylltarinë e qëndrueshme, si Certifikimi i Pyjeve, Prerjet e paligjshme, Qeverisja e Pyjeve, Ruajtja e Biodiversitetit, Menaxhimi intensiv i plantacioneve pyjore, dhe së fundmi edhe Pyjet Komerciale dhe Reduktimin e Varfërisë dhe Pyjet dhe Ndryshimet Klimatike.

Sipas TFD, dialogët mbi Pylltarinë Komerciale dhe Reduktimin e Varfërisë dhe Menaxhimin Intensiv të Plantacioneve Pyjore, kanë nxjerrë në pah çështje që lidhen me pylltarinë lokale. Si rrjedhim, deri më tani është zhvilluar një i ashtuquajtur dialog fillestar në Bruksel (2009) dhe dialogë në terren, në Panama mbi problemet e pronarëve indigjenë, dhe në Kathmandu/Nepal mbi çështjet e pylltarisë komunale (2009).

Dialogu i tretë në terren zhvillohet në IRJ të Maqedonisë dhe Shqipëri, duke krijuar një mundësi për të diskutuar rastet Evropiane lidhur me këto çështje për rajonin e EJL. Rajoni i EJL është një nga ato rajone në Evropë me shumë ndryshime politike dhe ekonomike gjatë periudhës së fundit, duke krijuar mundësi të reje biznesi dhe investimi përgjithësisht duke krijuar ekonominë e tregut, çka natyrisht prek sektorin e pylltarisë private. Bazuar mbi sa më sipër, mund të thuhet se në Evropë është vendosur më së miri një dialog ndërkombëtar politik mbi pylltarinë në shkallë të vogël dhe opsionet e investimit në të në EJL, ku kërkohet ndikimi praktik dhe aktualiteti, pasi ky rajon në Evropë është në kërkim gjithnjë e më shumë të lidhjeve të biznesit dhe investimeve.

Në këtë kontekst Konfederatë Evropiane e Pronarëve të Pyjeve është përzgjedhur të koordinojë këtë detyrë rajonale dhe të sigurojë një studim mbështetës për “Dialogun në EJL” të TFD. Për të evidentuar tendencat dhe observacionet e përgjithshme janë përgatitur dy raste studimore kombëtare mbi këtë çështje: një nga Maqedonia dhe një nga Serbia.

Konfederata Evropiane e Pronarëve të Pyjeve ka drejtuar aktivitete që synojnë drejt vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore që prej 2003/2004. Këtu përfshihen shkëmbimet midis pronarëve të pyjeve dhe organizatave të tyre dhe puna në nivel politik, së bashku me administratat pyjore kombëtare, FAO dhe IUCN apo Komisioni Evropian. Si rrjedhim, janë organizuar një sërë aktivitetesh përgjatë këtij bashkëpunimi si dhe janë hartuar projekt ide dhe disa prej tyre edhe janë zbatuar.

Në 2008–2009 CEPF është përfshirë në rajonin e EJL në nivel projekti dhe ka koordinuar një projekt të financuar nga Banka Botërore Programi PROFOR, që adreson hartimin e politikave pyjore lidhur me pyjet privatë në rajonin e EJL. Projekti e preku këtë çështje në tre vende brenda kuadrit politik të programeve pyjore kombëtare përkatëse apo proceseve strategjike (Shqipëri, Maqedoni, dhe Serbi). Puna e kryer përfshin fazën analitike me hartimin e të ashtuquajturës analiza kombëtare e gjendjes së pyjeve jo-shtetërorë dhe fazat praktike me takime të organizuara në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Organizata ndërkombëtare si SNV dhe FAO kanë bashkëpunuar në zbatimin e këtyre aktiviteteve. Kontributi i CEPF në

serinë e dialogëve për pylltarinë lokale të TFD rrjedh nga këto aktivitete si një vazhdimësi që adreson investimet dhe lidhjet e biznesit për pylltarinë jo-shtetërore.

Dialogu fillestar në Bruksel identifikoi dy terma kryesore që mund të përdoren edhe këtu—pylltaria lokale dhe investimi—si më poshtë:

“...ne e konsiderojmë **pylltarinë lokale** si gama e aksioneve për të menaxhuar apo rritur burime pyjore dhe administruar ndërmarrje të vogla bazuar mbi mallrat apo shërbimet pyjore, të ndërmarra nga pronarë të vegjël, grupe të komunitetit, njerëz që varen nga pylli dhe grupime të tjera lokale, dhe mbi të cilat ata kanë një fuqi thelbësore vendim-marrëse.”

“...**investimi** është kuptuar këtu në kuadrin e gjerë të aksioneve që mund të përmirësojnë asetet e pylltarisë lokale, kryesisht sigurimin e financimeve dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe sistemeve praktike të menaxhimit.”

**Rëndësia politike** e kësaj çështjeje theksohet duke thënë se: “...nën kushtet e duhura, pylltaria lokale mund të jetë një kontribuues i fuqishëm në të ardhurat lokale dhe zhvillimin e qëndrueshëm...” kryesisht në Evropë referuar si në zonat rurale apo si pjesë e politikave të zhvillimit rural. “...shpesh kjo kërkon përmirësimin e investimeve për të arritur këtë potencial, ndërkohë që këto investime mungojnë apo nuk shkojnë në vendin e duhur... Punë e konsiderueshme është bërë për këto çështje, por ende dilemat dhe problemet kryesore mbeten të pazgjidhura ...”

Këtu më poshtë jepen disa karakteristika dhe deklarata që përcaktojnë kuadrin e përgjithshëm për këtë informacion në nivel ndërkombëtar (TFD 2009):

- ➔ Sipas Bankës Botërore, rreth 1.6 bilion njerëz jetojnë në ekosisteme të mbizotëruara nga pyjet apo pranë tyre. Pyjet janë burim i rëndësishëm për të varfrit në zonat rurale, me mbi 800 milion njerëz që jetojnë në pyjet dhe drunishtat në tropik<sup>1</sup>. Numri i pronarëve të vegjël familjarë të pyjeve mund të vlerësohet tek rreth 30 milion në vendet e zhvilluara<sup>2</sup>. Vlerësime të besueshme për vendet në zhvillim mungojnë por numri i tyre vlerësohet gjithashtu në dhjetëra milionë. Përveç kontributit në të ardhura nëpërmjet sigurimit të mbijetesës, pyjet mund të sigurojnë një burim të ardhurash kesh, një vlerë kapitale, një burim punësimi dhe një sistem alternative të kujdesit shëndetësor bazuar në bimët pyjore.
- ➔ Grupet indigjene dhe komunitetet zotërojnë apo menaxhojnë rreth 20% të pyjeve në vendet në zhvillim m<sup>3</sup>. Sipas Aleancës Globale të Pylltarisë Komunitare, më shumë se 9 milion njerëz varen direkt nga produktet apo të ardhurat nga pylltaria komunitare por ka mundësi që kjo sasi të jetë tepër e nënvlerësuar, pasi në shumë vende pyjet e komunitetit nuk janë të organizuara si duhet për të dhënë vlerësime të besueshme mbi anëtarët e tyre. Sektori i pylltarisë komunitare po zgjerohet me shpejtësi pasi qeveritë në shumë vende në zhvillim (Kameruni, Kina, Gana, India, Tailanda, Peruja, Bolivia dhe Kolumbia veç të tjerash) po transferojnë pronësinë, menaxhimin apo të drejtat e përdorimit tek komunitetet lokale nën marrëveshje të ndryshme.

#### **Disa nga problemet kryesore të identifikuar gjatë këtyre zhvillimeve (TFD 2009):**

- ➔ Edhe kur janë ndërmarrë reformat ligjore mbi rregullimin e pronësisë, kuadri rregullator reflekton marrëveshje ligjore dhe pronësie të dala jashtë mode apo tradicionale dhe është pothuajse e pamundur për pronarët e vegjël dhe komunitetet të përfitojnë nga reformat politike dhe ligjore. Shpesh rregulloret veprojnë si barriera për akses të ligjshëm ndaj pyjeve dhe tregjeve, rrisin padrejtësisht kostot e transaksioneve për ndërmarrjet komunitare dhe nxisin korrupsionin dhe ndarjen e padrejtë të përfitimeve.
- ➔ Përgjithësisht, popullsitë indigjene, pyjet e komunitetit dhe pronarët e vegjël janë të keq organizuar, çka nënkupton që si aktorë tregu, ata nuk mund të ndikojnë në çmimet potenciale të shitjes së produkteve të tyre. Kapacitetet e


ulëta teknike dhe menaxheriale përbëjnë një pengesë thelbësore për zhvillimin e tyre duke i bërë komunitetet të prekshëm ndaj presioneve të jashtme për aktivitete të paligjshme.

- ➔ Mungesa e aksesit ndaj kapitalit është një pengesë thelbësore jo e vogël, pasi tokat e komunitetit apo indigjeneve shumë rrallë përdoren si kolateral dhe sektori bankar ka pak ose aspak njohuri mbi financimin e investimeve në pyje.
- ➔ Komunitetet dhe pronarët e vegjël janë gjithashtu në disavantazh për sa i përket plotësimin të kërkesave të tregut, të cilat po bëhen gjithnjë e më kërkuese dhe komplekse. Kërkesa, si verifikimi i pajtueshmërisë ligjore, certifikimi i praktikave të qëndrueshme dhe gjurmueshmëria e produkteve pyjore, kanë treguar që janë tepër sfiduese.
- ➔ Shqetësime janë ngritur mbi kërcënimet potenciale mbi të drejtat ligjore apo tradicionale dhe statusin e njerëzve që varen nga pyjet, të cilët mund të përballen me kosto të papërbalueshme dhe humbje ekonomike nëse u kufizohet aksesin ndaj burimeve pyjore. Këto kërcënime mund të përfshijnë orientimin e papërshtatshëm të mbështetjes financiare që çon në kufizimin e aksesit të popullatës ndaj burimeve të tyre pyjore apo investime të papërshtatshme në forcimin e kapaciteteve për strukturat lokale.

## 2: SITUATA E PYJEVE DHE PYLLTARISË NË EJL – TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE TENDENCAT SUB-RAJONALE (BAZUAR NË KMMPE 2007)

Sub-rajoni i EJL<sup>4</sup> përfshin rreth 32.8 milion ha pyje dhe afërsisht 15.6 milion ha toka me bimësi pyjore dhe përfaqëson rreth 16% të pyjeve dhe 42% të tokave me bimësi pyjore në Evropë pa Rusinë (shih grafikun 1). Kjo do të thotë që në vija të përgjithshme një e treta e sipërfaqes së saj është e mbuluar nga drurë apo bimësi pyjore. Në përgjithësi vërehet një tendencë e vogël në rritje për pyjet dhe një pakësim i sipërfaqeve të tjera me bimësi pyjore, çka i korrespondon një rritjeje modeste të rritjes së vëllimit drusor. Megjithatë, Shqipëria dhe Serbia kanë raportuar humbje midis viteve 2000 dhe 2005 për të dyja këto zëra. Është interesante që ndërkohë që, sipërfaqja e pyjeve fletorë është rritur që nga viti 2000, sipërfaqja e pyjeve të përzier është zvogëluar vazhdimisht në EJL.

GRAFIKU 1. HARTA E PYJEVE TË EVROPËS DHE MBOLESA PYJORE E EVROPËS JUG LINDORE.



Sipërfaqja e pyjeve e vlefshme për furnizimin me dru zjarri në 2005 është raportuar të jetë 82%, me një rritje të lehtë nga 1990 deri në 2005. Kjo përqindje është e barabartë me atë të vendeve Nordike/Baltike të Evropës, dhe afërsisht 10% më e ulët se ajo e Evropës Qendrore dhe Veri-Perëndimore. Rritja vjetore neto është në ngritje të qëndrueshme (91 milionë m<sup>3</sup>/vit) ndërkohë që shfrytëzimet vjetore janë pak a shumë të qëndrueshme dhe shkojnë rreth 40–41 milionë m<sup>3</sup>/vit (1990–2005). Në Evropën Jug-Lindore vendet kanë raportuar në NAI një nivel vjetor shfrytëzimi më të vogël se 50%, përveç Shqipërisë ku niveli i shfrytëzimeve i ka kaluar 300% në 2000 dhe 500% në 2005 duke bërë kështu një shkelje të pafalshme të normave të lejueshme të shfrytëzimit.

Lidhur me çështjet silvikulturore, rajoni është i njohur për përdorimin e gjerë të regjenerimit natyror në përgjithësi dhe veçanërisht për praktikën e ricungimit (Shqipëri, Bullgari, Maqedoni, Serbi). Megjithatë, është e çuditshme që në Evropë vetëm Serbia dhe Shqipëria në vitin 2005 kanë raportuar mbi 30 lloje drusore të rrezikuara ndërkohë që shumica e vendeve numërojnë 0–4 lloje të kërcënuara. Në Shqipëri një lloj drusor është raportuar si i zhdukur. Nga ana tjetër, zona të gjera janë nën mbrojtje për ruajtjen e biodiversitetit apo pejsazheve. Për shembull, në Shqipëri dhe Serbi kjo shifër është mbi 20%, ndërsa në Kroaci, Greqi, Bullgari dhe Rumani ajo është më e vogël se 10%.

Rajoni është gjithashtu i njohur për traditat e fuqishme rurale çka tregojnë që prodhimet e dyta pyjore kanë një rëndësi të jashtëzakonshme ekonomike dhe përdorim personal. Për shembull, midis vendeve që raportojnë në MCPFE (Konferenca Ndërmministrorë për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë) Bullgaria është prodhuesi kryesor i kërpudhave për nga sasia ndërkohë që Serbia është vendi me vlerën më të lartë për ton; Shqipëria është e njohur për imët e saj mjekësore dhe Maqedonia për prodhimin e mjaltit.

Kur flasim për disa tendenca të përgjithshme të sektorit pyjor, mund të themi që në EJT ai luan, bazuar në vlerat e PBB, një rol të vogël pasi kontribuon vetëm me 1%, por sidoqoftë pak më të lartë se ai në Evropën Veri-Perëndimore apo Jug-Lindore apo Lindore përfshirë Rusinë. MCPFE (2007) thekson se, "...në terma të vlerës së shtuar brenda sektorit, pylltaria dhe aktivitetet e shfrytëzimit janë më të rëndësishme në vendet Nordike/Baltike dhe në Evropën Lindore dhe Jug-lindore, ndërsa në rajone të tjera, vlera e shtuar është përqendruar në industrinë pyjore". Të dhëna të mëtejshme specifikojnë që vlera e shtuar bruto e industrisë së letrës në EJT është më poshtë se ajo e pyjeve dhe shfrytëzimit, dhe rreth 45% do të prodhohet nga industrinë e përpunimit të drurit. Kjo thekson që ato pjesë të sektorit pyjor që kërkojnë më tepër teknologji dhe investime, siç janë industria e letrës apo bio-energji, janë përgjithësisht të pazhvilluara në këtë rajon. Megjithatë, që prej vitit 2000, kontributi i rajonit në vlerën e shtuar të sektorit pyjor në Evropë është në rritje (MCPFE 2007).

Për sa i përket fuqisë punëtore në sektor, EJT është rajoni me punësimin më të madh në Evropë në aktivitete silvikulturore dhe shfrytëzimi me rreth 45% të totalit të Evropës, duke treguar një tendencë të qëndrueshme që nga viti 2000. Në gjithë sektorin e pyjeve në Evropë, përfshirë industrinë, EJT numëron rreth 800'000 vende pune nga 3.5 milion gjithsej (23%). Megjithatë, vetëm pak vende Evropiane raportojnë një rritje të punësimit në sektor për periudhën 2000–2005, ndër të cilët janë Turqia dhe IRJ Maqedonisë nga EJT. Tendanca e përgjithshme në Evropë tregon qartë një ulje të nivelit të punësimit midis -2.0% dhe -6.9% për vitet 1990–2000 dhe -0.3% dhe -3.6% për vitet 2000–2005. Për më tepër, duhet theksuar se "Turqia dhe Evropa Jug-Lindore kanë nivelin më të lartë të punësimit në raport me sipërfaqen pyjore." (MCPFE 2007). Kjo ndoshta ngre disa pyetje mbi efikasitetin e fuqisë punëtore dhe zhvillimin e teknologjisë në sektor.

Tregtia e drurit për sa i përket eksporteve si dhe importeve ka pasur një rritje thelbësore që nga 1992, dhe tani ka një vlerë 4–5 herë më të madhe se në fillim. Ajo mbulon më pak se 10% të vëllimit Evropian. Megjithatë, rajoni është një eksportues neto i produkteve drusore.

Në rajon, Shqipëria, Serbia, Rumania dhe Bullgaria kanë provuar ndryshime serioze në kushtet e pronësisë mbi pyjet që prej 1990, duke sjellë një rritje të pyjeve privatë apo të komunitetit.

### 3: PYLLTARIA PRIVATE DHE KOMUNITARE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ajo çka kanë të përbashkët vendet e Ballkanit Perëndimor Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i zi, dhe Serbia është që pyjet e tyre janë burime të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë rurale dhe pronës private (PRIFORT 2009). Pjesa e pyjeve private ndryshon shumë midis vendeve duke shkuar nga 2% në Shqipëri deri në mbi 50% në Serbi, dhe në vendet e tjera ajo nuk është më shumë se 20%. Megjithatë, duke qenë se procesi i kthimit të pronave dhe privatizimit është ende në vazhdim, këto shifra mund të ndryshojnë së shpejti.

TABELA 1: PRONËSIA MBI PYJET PRIVATË NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR, 2004–2008

Vendi	Sipërfaqja pyjore (10 <sup>3</sup> ha)	Pyjet privatë (10 <sup>3</sup> ha)	Përqindja e pyjeve privatë (%)	Numri i pronarëve të pyjeve privatë (10 <sup>3</sup> )	Madhësia mesatare e pronës pyjore (ha)
Shqipëria <sup>5</sup>	942	19	2	15	1.10
Bosnja dhe Hercegovina	2,710	523	19	500	1.00
Kroacia	2,487	473	19	600	0.77
Maqedonia	997	96	10	240	0.40
Mali i zi	770	161	21		
Serbia	2,200	1,148	52	500–800	1.0–2.2

Burimi: PRIFORT, 2009

Numri i pronarëve të pyjeve privatë është i pasigurt, megjithatë ai pak a shumë arrin në 2 milionë, çka tregon një mesatare shumë të vogël të madhësisë së pronave prej rreth 1.0 ha për person (shih Tabelën 1). Kështu, në kuadrin e përgjithshëm, në Ballkanin Perëndimor dominojnë pronat e vogla pyjore. Megjithatë, rreth 25% e pronarëve zotërojnë pyje më të vegjël se 1.0 ha dhe gjithashtu një numër i konsiderueshëm pronarësh zotërojnë më shumë se 3.0 ha, veçanërisht në Serbi – 38% e pyjeve privatë (PRIFORT 2009). Pyjet komunalë ekzistojnë vetëm në Shqipëri dhe zënë rreth 356'000 ha apo 38% të sipërfaqes së pyjeve të vendit.

Ky informacion paraqet zhvillimet e pylltarisë private/komunale në EJT dhe duke nënvizuar çështjet që lidhen me investimet. Detaje të mëtejshme do të jepen për tre raste të zhvillimit të pyjeve jo-shtetërorë në EJT: Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri.


#### 3.1: ZHVILLIMI I PYLLTARISË PRIVATE NË MAQEDONI (BAZUAR MBI TRENDAFILOV ET AL. 2008)

##### Historiku i shkurtër i pyjeve privatë

Arkivat mbajnë dokumente mbi pyjet në territorin e Republikës së Maqedonisë që nga koha e Perandorisë Osmane dhe vetëm pak për kohën e sotme para luftës së dytë botërore.

Pas luftës së dytë botërore një pjesë e madhe e tokave privatë, përfshirë pyjet, u shtetëzuan dhe u krijuan kooperativat socialiste. Në vitet 1950 pyjet private u shtetëzuan dhe pronarët humbën të drejtat e tyre të menaxhimit. Megjithatë, në shumë zona të Maqedonisë procesi i shtetëzimit të tokave private nuk u dokumentua si duhet. Kështu që procesi i rikthimit, filluar së fundmi, ka hasur vështirësi në rikthimin e situatës origjinale. Familjet që zotëronin pyjet kanë ndryshuar mënyrën e jetesës dhe nuk i përdorin më pyjet dhe parimet e pylltarisë tradicionale. Pronarët e parcelave të vogla humbën interesin në menaxhimin e tyre.

**GRAFIKU 2. SHPËRNDARJA E PYJEVE SIPAS TIPAVE TË PYLLIT NË IRJ TË MAQEDONISË DHE ZYRAT E DEGËVE TË SHOQATËS KOMBËTARE TË PRONARËVE PRIVATË TË PYJEVE**



2005/2008

Në vitin 1991 Maqedonia bëhet shtet i pavarur dhe e drejta e pronësisë mbi tokën u mundësua sërish. Shpejt filluan proceset e rikthimit të pronave dhe sipërfaqet e pyjeve privatë u shtuan, garantuar nga dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit të rikthimit të pronave. Megjithatë, rezultatet e procesit të rikthimit nuk dhanë efektet e pritshme. Në vitin 2008 procesi u ndal dhe nuk ka filluar më që atëherë. Pritet që procesi të vazhdojë, por megjithatë mundësia është vetëm për një rritje prej 2–3% të sipërfaqes së pyjeve privatë. Nga rreth 1.4 milion ha sipërfaqe pyjore, pyjet e inventarizuar mbulojnë rreth 950'000 ha, nga të cilët rreth 65% janë cungishte dhe shkurre (2006). Vëllimi në këmbë i këtyre pyjeve është rreth 51.5 milionë m<sup>3</sup>, ose 39.6% e totalit.

Vëllimi mesatar prej 96.4 m<sup>3</sup>/ha është në fund të vlerave Evropiane dhe tregon në përgjithësi një cilësi të ulët të pyjeve në Maqedoni. "...kjo rrjedh si pasojë e shkaqeve historike, sociale dhe ekonomike. Në përgjithësi pyjet në Maqedoni, dhe veçanërisht cungishtat përballen me një degradim dhe shkatërrim të vazhdueshëm." (Trendafilov et al. 2008). Për sa i përket pronësisë, pyjet privatë mbulojnë 125'872 ha. Pyjet shtetërore mbulojnë 861'502 ha (Burimi: State Statistical Office data, 1996). Por, sipas planeve të menaxhimit janë 903'587 ha pyje në pronësi të shtetit (90%) dhe rreth 97'423 ha në pronësi të privatëve (10%).<sup>6</sup>

Pyjet private janë mesatarisht në sipërfaqe të vogla me prodhimtari të ulët. Ka rreth 220'000 parcela pyjesh private në vend të zotëruara nga 65'000 familje, çka do të thotë rreth 200'000 pronarë pyjesh. Madhësia mesatare e pronës është rreth 0.5 ha.

Pyjet shtetërore dhe private janë njëlloj të detyruar për të pasur plan menaxhimi. Planet përgatiten ekskluzivisht nga Departamenti i Planeve të Menaxhimit të Pyjeve që vepron brenda Ndërmarrjes Publike të Pyjeve "Makedonski Sumi."

Pyjet private janë të ndarë në 220'000 parcela, me një mesatare prej 0.4 ha për pronar. Ligji i pyjeve i 1997, i jep mundësinë pronarëve të pyjeve privatë mbi 100 ha të kenë planin e tyre të menaxhimit të hartuar nga staf i kualifikuar. Ky opsion nuk është përdorur deri më tash dhe ka mbetur vetëm teorik.

Të gjitha shërbimet për pronarët e pyjeve privatë, si damkimi i drurëve apo lëshimi i lejeve të transportit, që prej 1998 bëhet nga Ndërmarrja Publike e Pyjeve "Makedonski Sumi." Deri më 1998, shërbimet siguroheshin nga Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave. Sipas Trendafilov (2008) kjo ka funksionuar më mirë se sistemi i sotëm, si pasojë e konfliktit të interesit në Ndërmarrjen Publike të Pyjeve si organizmi menaxhues dhe siguroesi i shërbimeve në të njëjtën kohë.



Në politikën pyjore të vendit, arritja më thelbësore ka qenë Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pylltarisë në Maqedoni. Ajo është hartuar në 2005 dhe miratuar nga parlamenti në 2006. Ajo përcakton kuadrin e përgjithshëm për të gjitha vendimet kryesore lidhur me pylltarinë për 20 vitet e ardhshme. Synimet dhe masat në planin e saj të veprimit lidhen me të gjitha pyjet e vendit. Qëllimi i qeverisë është të risë kontributin e pylltarisë në ekonomikë kombëtare dhe rurale nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Pylltaria duhet të sigurojë të mira dhe shërbime për përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Në strategji, kuptimi mbi pyjet lidhet kryesisht me përdorimin e tyre si burim për prodhimin e të mirave materiale si lëndë drusore, prodhime të dyta pyjore (bime, kërpudha, fruta, gjah, etj).

Pak çështje nga ky dokument lidhen veçanërisht me pyjet privatë. Megjithatë, pronarët privatë të pyjeve konsiderohen si një bazë e mirë për hartimin e strategjisë së Shoqatës dhe pylltarisë private në përgjithësi (NAPFO 2006).

Në përgjithësi, Plani i Veprimit për zbatimin e strategjisë ka qenë i ngadaltë deri tani me vetëm pak rezultate (2008). Janë zhvilluar Seminare informuese dhe konsultime mbi menaxhimin e pyjeve për pronarët e pyjeve privatë në përgjithësi dhe mbi pyllëzimet në veçanti. Gjithashtu, është realizuar sigurimi i informacionit mbi pronarët e pyjeve dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme që lidhen me to. Shoqata ka adresuar çështje të Ligjit të Pyjeve duke bere propozime të detajuara pas konsultimit të anëtarëve të saj dhe administratës. Shumë prej aktiviteteve të planit të veprimit janë ende në vazhdim.

### 3.2: ZHVILLIMI I PYLLTARISË PRIVATE NË SERBI (BAZUAR MBI NONIC & MILIJIC, 2008)

Inventari Kombëtar i Pyjeve përcakton 2.2 milion ha pyje në Serbi (2008) me 29.1% të territorit të vendit.

Pyjet private dominojnë strukturën e pronësisë dukë zënë afërsisht 52.2% të sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve, ndjekur nga pyjet shtetërorë që zënë 39.8% të sipërfaqes së pyjeve. Në 2008, pronësia për rreth 8% të pyjeve nuk ishte përcaktuar ende. Vlerësohet që pjesa e pyjeve privatë ndaj sipërfaqes totale të pyjeve do të rritet në 56%, kur të saktësohet pronësia e kësaj pjese të pyjeve.

Vëllimi total në pyjet privatë është mbi 162 milion m<sup>3</sup>, çka përfaqëson 45% të vëllimit total të pyjeve në Serbi. Vëllimi mesatar është 138.5 m<sup>3</sup>/ha, dhe rritja vjetore është në nivelin e pyjeve shtetërorë, 4.2 milionë m<sup>3</sup>.

#### Zhvillimi i pronësisë në pyje

Në shekullin e 19 pyjet ishin kryesisht në pronësi publike dhe konsideroheshin si burim i mirëqenies shoqërore. Format e ndryshme të pronësisë—private, komunale, rurale—u formuan më pas në fund të shekullit të 19 dhe u përcaktuan në Ligjin e parë Serb për pyjet të 1891. pas luftës së dytë botërore, politika favorizoi sektorin pyjor publik nëpërmjet krijimit të të ashtuquajturve prona sociale nga shtetëzimi i pyjeve shtetërorë, komunalë, privatë, manastiret dhe pyjet e kishës. Megjithatë, de jure, pronësia private mbi pyjet ekzistonte në ish Jugosllavi përgjatë gjithë periudhës së pas L2B, ndryshe nga shumica e vendeve socialiste të “Bllokut të Evropës Lindore,” edhe pse opsionet e menaxhimit që pronarët privatë kishin ishin shumë të kufizuara. Legjislati dhe objektivat e menaxhimit të pyjeve përcaktuar nga planet e menaxhimit nuk ishin shumë të ndryshme në pyjet private krahasuar me ato shtetërorë. Mangësitë kryesore të këtyre rregulloreve ishin mungesa e politikave dhe strategjive të qarta, dhe politikave të administrimit shtetëror mbi pyjet private (kryesisht, asnjë incentivë, këshillim apo mbështetje për organizim—Nonic, Milijic 2008).<sup>7</sup>

Në 2008, struktura e pyjeve privatë në Serbi paraqet një numër të madh pronarësh privatë, respektivisht me një pronë të vogël deri mesatare, në parcela të vogla. Më shumë se 72% e pronarëve kanë prona më të vogla se 1 ha, 26% zotërojnë prona nga 1 deri 10 ha, dhe vetëm 2% e pronarëve të pyjeve kanë prona pyjore më të mëdha se 10 ha (NFI 2008). Për këtë Milijic (2008) thekson se “...sektori i pyjeve privatë në Serbi karakterizohet nga një fragmentim i madh i pronave, numër i madh parcelash dhe pronarësh dhe menaxhim i pamjaftueshëm.”

Megjithëse pronarët e pyjeve privatë i menaxhojnë vetë pyjet e tyre, ndërmarrjet pyjore publike janë të ngarkuara me detyra teknike bazë për menaxhimin e pyjeve privatë.<sup>8</sup> Në përputhje me ligjin e pyjeve nga 1991, pronarët privatë kanë detyrimet e mëposhtme (Nonic, Milijic 2008):

- ➔ Të punojnë në përputhje me planin e menaxhimit të pyjeve;
- ➔ Caktimi i drurëve para shfrytëzimit të bëhet nga shërbimi privat i pyjeve;
- ➔ Kompensim i detyrueshëm për shfrytëzimin të cilin pronari ia paguan shërbimit pyjor privat të Ndërmarrjes Publike<sup>9</sup>;
- ➔ Damkim i detyrueshëm i lëndës dhe druve të zjarrit dhe leje e transportit lëshuar nga Ndërmarrja Publike e Pyjeve.

Aktualisht, ekzistojnë dy forma të organizatave të pronarëve të pyjeve në Serbi – modeli i pyjeve të komunitetit, i cili synon në menaxhimin e përbashkët të pyjeve, dhe shoqata e pronarëve privatë të pyjeve, e cila synon përfaqësimin e interesit të anëtarëve ndërsa kryejnë shumicën e detyrave individuale të menaxhimit të pyjeve që zotërojnë.

Ekziston vetëm një i ashtuquajtur pyll i komunitetit në Serbi, i cili është zhvilluar vazhdimisht që prej 1903—*Sumska zajednica* Beocin. Ai ka mbledhur rreth 80 pronarë që nga ajo kohë dhe është unik në ekzistencën dhe organizimin e tij. Në periudhën 2006–2009, janë krijuar një sërë shoqatash të pronarëve të pyjeve (rreth 14 në 2009). Shoqatat janë OJQ dhe statutet dhe objektivat e përgjithshme të tyre janë mjaft të ngjashme (Milijic, 2007). Shoqata si entitet koordinon punët e përbashkëta si përmirësimi i infrastrukturës pyjore, apo marketingun e përbashkët të produkteve dhe aktivitetet e trajnimit. Ato bashkëpunojnë në nivel kombëtar dhe kanë krijuar Federatën e Shoqatave të Pronarëve të Pyjeve në Serbi në 2009. Kjo strukturë kombëtare e organizimit të pronarëve të pyjeve është e ngjashme me atë të Kroacisë.

### Zhvillimi i politikave

Në korrik 2006, u miratua Strategjia e Zhvillimit të Pyjeve në Republikën e Serbisë. Strategjia përcakton rolin e shtetit në sektorin pyjor si dhe rolin e sektorit pyjor në zhvillimin kombëtar duke adresuar gjithashtu edhe çështje të ruajtjes së mjedisit. Për më tepër, strategjia përcakton edhe lidhjen midis pyjeve shtetërore dhe privatë.

Një nga elementët kryesorë të strategjisë është edhe reforma institucionale në sektorin e pyjeve, e cila përfshin çështjet e mëposhtme:

- ➔ Ri-përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve në pyje, në nivel lokal, rajonal dhe qendror dhe lidhjet midis tyre;
- ➔ Rritjen e rolit të sektorit privat në sigurimin e të mirave dhe shërbimeve;
- ➔ Zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të OJQ-ve në nivel lokal;
- ➔ Përcaktimin e rolit të pylltarisë në zhvillimin rural;
- ➔ Transparencën.

Strategjia gjithashtu lidhet me detyrat ligjore që duhen plotësuar dhe përcakton hartimin e një ligji të ri për pyjet, si dhe përcakton Programin Kombëtar të Pyjeve si planin e veprimit për zbatimin e saj.

Gjithashtu, strategjia thekson nevojën për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme në pyje. Në Serbi, kjo është veçanërisht e rëndësishme në zonat rurale dhe lidhet me prodhimin e lëndës drusore dhe druve të zjarrit për nevojat e veta dhe më pak për qëllime komerciale. Synimi kryesor për krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme në pyje është lehtësimi i rritjes së kontributit të pyjeve në zhvillimin ekonomik dhe social për përmirësimin e standardeve të jetesës dhe rritjen e punësimit. Më tej, është hartuar një Strategji për Zhvillimin e NVM-ve në pyje dhe industritë e lidhura me pyjet dhe nxitjen e nismave private për periudhën 2003–2008. ajo adreson opsionet mbështetëse në përgjithësi, pengesat ligjore, elementet financiare, edukimin dhe trajnimin, nxitjen e eksportit dhe çështjet teknike.



Nonic & Milijic (2008) arrijnë në përfundimin se këto dokumente strategjike dhe përpjekjet për zbatimin e tyre duhet të çojnë në zhvillimi të rëndësishme për pylltarinë private në Serbi.

### 3.3: ZHVILLIMI I SEKTORIT PYJOR JO SHTETËROR NË SHQIPËRI (BAZUAR MBI LAKO, 2008)

Pyjet zënë më tepër se 50% të sipërfaqes së vendit.

Bujqësia dhe pylltaria janë dy komponentët kryesorë të jetës rurale në ekonominë kombëtare. Fshatarët menaxhojnë njëkohësisht si bujqësinë dhe pyjet sipas disa sisteme tipike agro-pyjore. Në 1992 këto sektorë kontribuuan me 42.5% në vlerën e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Megjithatë, në 2005, pjesa e tyre ishte vetëm 20.7% e PBB, ulur ndjeshëm por ende shumë i rëndësishëm. Statistikat tregojnë që të ardhurat vjetore nga sektori i pyjeve shkojnë në 0.83–1.5 milionë Euro në vit, të ardhurat nga materialet drusore zënë 50–75% të saj, dhe bimët mjekësore dhe prodhimet e dyta pyjore zënë 12–30% [ANFI Project—Special Study on Forest and Pasture General Plan, 2004]. Të ardhurat në 2002 shkuan deri në 1.44 milionë Euro.

Përveç, lëndës dhe druve të zjarrit zonat pyjore përdoren edhe për kullotjen e bagëtive dhe sigurimin e gjethit. Kjo kontribuon rëndësishëm në të ardhurat e familjes rurale. Ka tregues që të ardhurat nga pyjet (dru zjarri, lëndë, kullotë, gjeth) shkojnë deri në 20% të të ardhurave totale të familjeve rurale.

Është për tu shënuar që më shumë se 62% e pyjeve janë në terrene me një pjerrësi më të madhe se 40%, çka tregon vështirësitë me të cilat përballen menaxherët e pyjeve në Shqipëri, veçanërisht për sa i përket shfrytëzimit të pyjeve. Përkundër këtyre faktorëve pengues, kushtet janë të favorshme për rritjen e pyjeve por prodhimtaria e pyjeve (mesatarisht 1.4 m<sup>3</sup>/ha/vit) është shumë më e ulët se në vendet e tjera Evropiane. Ndryshimet në peizazh për hapjen e tokave të reja bujqësore, mbi kullotja, zjarret si dhe presioni i druve të zjarrit dhe lëndës drusore nga popullsia në rritje, janë faktorë të rëndësishëm për degradimin e pyjeve në Shqipëri.

Shqipëria ka rreth 415 gatra për përpunimin e lëndës drusore, të cilat përpunojnë çdo vit një vëllim prej 360,000 m<sup>3</sup> lëndë drusore.

Shqipëria është e mirënjohur për cilësinë e prodhimeve të dyta pyjore, si bimët mjekësore, eterovajore, etj. Mbi 7'400 ton me një vlerë rreth 10 milion USD eksportohen mesatarisht çdo vit (2004).

Gjatë 60 viteve të fundit të komunizmit dhe periudhës së tranzicionit Shqipëria ka pësuar ndryshime thelbësore. Sipërfaqja pyjore është reduktuar me më shumë se 300'000 ha dhe shumica e pyjeve janë degraduar nga mbi shfrytëzimi dhe mbi kullotja (MOAF, 1998). Gjithashtu, theksohet se degradimi i pyjeve dhe erozioni janë problemet kryesore në menaxhimin e burimeve natyrore në Shqipëri.

#### Zhvillimi historik i pronësisë private

Para 1945, si pasojë e ligjit të Sheriatit të Perandorisë Osmane, sipërfaqja e pyjeve private në Shqipëri ishte e vogël dhe nuk i kalonte 5% të sipërfaqes totale të pyjeve (63,000 ha). Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin e parë për pyjet në vitin 1923. Ligji njihte pyjet dhe kullotat private dhe u njihte pronarëve të drejtën e zotërimit dhe përfitimit. Ishte e ndaluar konvertimi i pyjeve në tokë bujqësore nëse nuk kishte përfitime të konsiderueshme. Nëse dikush priste drurë pa leje në një pyll privat, ai ishte i detyruar ta ripyllëzonte atë, përveç pagesës së gjobave. Njiheshin tre kategori të pronësisë mbi pyjet: (i) private; (ii) komunale (një njësi administrative e përbërë nga disa fshatra); dhe (iii) shtetërore.

Shtetëzimi i pyjeve u krye pas luftës së dytë botërore në 1945. megjithatë, pronësia private mbi pyjet u zhduk plotësisht në vitin 1966, kur kooperativat bujqësore u shtrinë në të gjithë vendin. Të gjitha tokat, përfshirë pyjet, u deklaruan pronë shtetërore nga kushtetuta e vitit 1976. gjatë regjimit komunist mbizotëronte ideja se “prona e përbashkët është pronë e

askujt,” dhe kjo çoi në degradimin e shumë zonave pyjore, veçanërisht atyre pranë fshatrave.<sup>10</sup> Burimet pyjore u vunë nën një presion të madh njerëzor (dru zjarri, kullotë) çka solli degradimin e tyre, veçanërisht të pyjeve të lartë apo pyjeve pranë qendrave të banuara. Investimet në menaxhimin e pyjeve ranë ndjeshëm që nga mesi i viteve 1980.

Prona private, përfshirë pyjet, u njoh sërish me ligj pas ndryshimeve social ekonomike të viteve 1990. procesi i rikthimit të pronave pas vitit 1990 synonte rikthimin e pyjeve privatë bazuar në pronësinë e vitit 1945. 19,000 ha ose 30% e sipërfaqes së pyjeve private u janë kthyer pronarëve deri në 2007. Prosesi i rikthimit është shumë i ngadaltë si pasojë e problemeve procedurale dhe një mungese të përgjithshme të njohurive mbi ligjin.

Ndërsa kullotat dhe livadhet e pretenduara nga pronarët u rikthyen plotësisht, sipërfaqja e pyjeve të kthyera ishte e kufizuar. Sipërfaqja e pyjeve të kthyera pronarëve nuk mund të ishte më shumë se 100 për pronë.

Transferimi i pyjeve në përdorim të Njësive të Qeverisjes Vendore-NQV (komuna/fshatra) ishte një nga reformat më të rëndësishme në sektorin e pyjeve. Transferimi bëhet në komunë e cila më pas harton marrëveshje me fshatrat apo përdoruesit individualë (familjarë).

Procesi i transferimit filloi në vitin 1996, në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Zbatimi i MPK u bazua në menaxhimin me pjesëmarrje të pyjeve komunalë nga komunitetet rurale të organizuar në Shoqatat e Përdoruesve të Pyllit dhe Komisionet e Pyjeve në bazë fshati dhe komune.

Treguesit kryesorë të arritjeve në menaxhimin e pyjeve komunalë gjatë periudhës 1996–2003 janë:

- ➔ 138 komuna me 1,290 fshatra ku ka përfunduar procesi i transferimit;
- ➔ 724 mijë banorë të fshatrave të përfshirë në MPK;
- ➔ 356,000 Ha pyje shtetërorë transferuar në përdorim NQV.

Transferimi i pyjeve sipas filozofisë së MPK nuk është thjesht një kthim i pyjeve por kthim i përgjegjësive për menaxhimin e pyjeve njerëzve që jetojnë pranë tyre. Prosesi është i gjatë dhe jo një transferim i thjeshtë i sipërfaqes pyjore “në përdorim” komunave dhe fshatrave. Prandaj, MPK është gjithashtu pjesë e procesit të fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të pushtetit vendor.

Një fazë e re e procesit të transferimit filloi në 2007. pyjet shtetërorë mund të transferohen në pronësi apo në përdorim të NJQV sipas kërkesës së tyre. Ky proces është përfunduar në të gjitha komunat e Shqipërisë dhe rreth 530'000 ha pyje janë tashmë pronë e komunave (2009). Në hapat e mëtejshëm të procesit, duhet të identifikohen të drejtat e përdorimit/pronësisë për fshatrat, familjet dhe individët në zonat ku do të jetë e nevojshme.

Për të qenë në gjendje të realizojnë menaxhimin e pyjeve komunalë, të gjithë përdoruesit e pyjeve komunalë anëtarësohen në SHPPK. Organizimi dhe funksionimi i SHPPK-ve është ende i dobët, dhe ligjërisht shqetësimet kryesore janë në dy probleme:

- ➔ Banorët lokalë nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi ligjin për SHPPK.
- ➔ Banorët lokalë mendojnë se SHPPK caktohen nga NJQV apo nga DSHP.
- ➔ SHPPK nuk kanë mundësi të gjenerojnë të ardhura.

Komunat dhe SHPPK janë organizuar në nivel rajonal në Federatat Rajonale për Pyjet Komunalë që janë ngritur për të mbështetur interesat e anëtarëve të tyre, Në vitin 2005, u krijua Shoqata Kombëtare Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHKPKK).

Për sa i përket pylltarisë private, Lako thekson (2008) se, “...Në Shqipëri, politika për menaxhimin e pyjeve privatë nuk është e plotë dhe procedurat për zbatimin e saj nuk ekzistojnë ende. Dispozitat ligjore nuk reflektojnë ndryshimet aktuale në menax-

himin e pyjeve privatë. Ligji i pyjeve dhe Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave i përmendin tangencialisht pyjet private, pa përcaktuar qëllimet dhe mënyrat për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.”

Mungesa e organizimit të pronarëve të pyjeve privatë është një nga çështjet kryesore në menaxhimin e pyjeve privatë. Aktualisht ekziston një Shoqatë Rajonale e Pyjeve Privatë me rreth 100 anëtarë me 10'500 ha pyje private. Sipas Lako (2008) pronarët privatë po përballen më një sërë vështirësish në menaxhimin e pyjeve të tyre. Problemet e mëposhtme e bëjnë të vështirë procesin e kthimit:

- ➔ Nuk ka dispozita ligjore që rregullojnë marrëdhëniet dhe sqarojnë të drejtat dhe detyrimet midis pronarit privat, shërbimit pyjor dhe pushtetit vendor, apo midis vetë pronarëve.
- ➔ Kthimi i pyjeve në zona turistike (ndërkohë që lejohet kthimi i tokës bujqësore) apo zona të mbrojtura nuk lejohet. Në këto raste pronarët duhet të kompensohen.
- ➔ Mungojnë dokumentet e pronësisë.
- ➔ Dispozitat ligjore lidhur me kthimin e pyjeve nuk njihen sa duhet.

Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri (SZhSPK) u hartua në vitin 1998 si pjesë e programit të USAID për Zhvillimin e Pylltarisë Private në Shqipëri (APFDP). Strategjia e gjelbër u pasua në vitin 1999 nga formulimi i të parës strategji për zhvillimin e pyjeve në Shqipëri. Strategjia e pyjeve synonte të jepte një kontribut optimal dhe rritjen ekonomike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe në 2004 është rishikuar. Tashmë objektivat e saj përfshijnë (Lako 2008):

- ➔ nënvizimit të lidhjeve dhe rëndësisë thelbësore të pyjeve për arritjen e objektivave të zhvillimit në sektorët e tjerë—bujqësia, energjia, uji, zhvillimi rural dhe turizmi—duke lehtësuar kështu përmirësimin e koordinimit të planeve dhe programeve;
- ➔ sigurimit që autoritetet qeveritare të nivelit të lartë kanë një kuptim të qartë mbi kontributin potencial të pyjeve në zhvillimin kombëtar duke siguruar kështu mbështetjen e saj me politikën, autoritetin dhe burimet e nevojshme
- ➔ lehtësimit të mbështetjes ndërkombëtare për pyjet duke lejuar partnerët e interesuar për zhvillim të shohin si burimet e tyre mund dhe do të përdoren në mënyrën më të mirë
- ➔ kapërcimit të paqartësive në sektorin privat që mund të pengojnë investimet pozitive (p.sh., për industrinë drurit apo zhvillimin e turizmit), dhe në nivel lokal, midis fermerëve, barinjve dhe popullsisë rurale, të cilat do të ndihen më të sigurt në ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tyre pyjore,

#### 4: SFIDAT PËR MENAXHIMIN E PYJEVE KOMUNALE E PRIVATË NË EJL

Këtu do të nënvizojmë disa çështje lidhur me problemet me të cilat po përballen pronarët e pyjeve në EJL, qoftë si individë qoftë si komunitet. Këto sfida në kontekstin e këtij informacioni janë shenja të dukshme të nevojave për investime dhe vazhdimin e reformave në menaxhimin e pyjeve.

Të dhënat përmbledhëse në tabelën 1, tregojnë që fragmentimi duhet të konsiderohet si një nga faktorët përcaktues të pylltarisë private në rajon. Megjithatë, ekzistojnë ndryshime thelbësore edhe për sa i përket pjesës së pyjeve të fragmentuar. Fragmentimi i pyjeve dominon në Serbi, ku kap 86% të pronave dhe është më i vogël në Maqedoni ku kap 57% të pronave (PRIFORT 2009).

Çështja e fragmentimit është shumë e lidhur edhe me gjendjen e pakënaqshme të kadastrës pyjore në pothuaj të gjithë vendet. Fragmentimi i parcelave e bën të vështirë shënimin e kufijve në terren. Ajo , gjithashtu, e bën tregtimin dhe

trashëgiminë e pyjeve pothuaj të pamundur. Megjithatë, këto probleme lidhen me reformat e tjera të tokës ashtu si edhe me gjithë sektorin bujqësor apo me zonat urbane. Kadastra është një problem në Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri.

Në Shqipëri kuadri ligjor mbi pyjet komunalë nuk është ende i pastruar nga kontradiktat dhe në të njëjtën kohë ekzistojnë rregullore të vjetra që janë ende në zbatim.

Pyjet komunalë kanë pasur një ecuri të mirë gjatë viteve të fundit. Shembuj pozitivë mund të gjenden kudo. Sesi transferimi i pyjeve në përdorim komunave ka çuar në përmirësimin e menaxhimit të pyjeve të degraduar (Lako 2008). Kjo ka rritur interesin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve dhe pushtetit vendor. Megjithatë, kjo ecuri nuk është në harmoni me aftësitë dhe përfitimet e përdoruesve në pyjet komunalë. DSHP është akoma institucioni qeveritar zyrtarisht përgjegjës për kontrollin dhe menaxhimin e pyjeve në rreth. Gjithashtu, DSHP ka kompetencat për menaxhimin, kontrollin dhe monitorimin e pyjeve shtetërorë, si dhe të pyjeve komunalë.

Megjithatë, duke vrojtuar kursin e zhvillimit të politikave pyjore për mbështetjen e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve shtetërorë dhe zbatimit të akteve ligjore e nënligjore për pyjet komunalë, sigurisht mund të thuhet se ka progres. Në çdo komunë të përfshirë në procesin e transferimit janë ngritur SHPPKK, të cilat më vonë krijuan federatat rajonale dhe Shoqatën Kombëtare. Në fund të vitit 2006, procesi i transferimit ishte realizuar në 138 komuna, duke përfshirë 1290 fshatra me 160,118 familje. Sot, ky proces është pothuajse i përfunduar në të gjitha komunat e Shqipërisë. Prosesi ka pasur kryesisht mbështetjen teknike e financiare të disa projekteve si PP/BB, APFDP financuar nga USAID, PZHBN, SNV dhe donatorë të tjerë. Eksperienca tregon që menaxhimi i pyjeve nga komunitetet lokale është i suksesshëm kryesisht për shkak të pasojave sociale, mjedisore dhe ekonomike që sjell pronësia lokale. Me gjithë këto arritje, ideja e shumë aktorëve është se procesi i transferimit po ecën me ngadalë dhe për më tepër nuk është përfunduar plotësisht në asnjë nga komunat, sepse familjet fshatare nuk kanë marrë asnjë dokument që provon të drejtat e tyre ekskluzive mbi pyllin e marrë në përdorim. Kjo ka ndodhur për një sërë arsyes, por më të rëndësishmet janë (Lako 2008):

- ➔ Politika të paqarta lidhur me sigurimin e të ardhurave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve nga komunitetet lokale
- ➔ Boshllëqe në aktet ligjore për pyjet komunalë dhe se ato nuk zbatohen si duhet
- ➔ Kapacitete të pamjaftueshme në NJQV për të asimiluar procesin
- ➔ Njohuri të pamjaftueshme mbi procesin nga përdoruesit dhe mosbesimi i tyre ndaj veprimeve të qeverisë, etj.

Lidhur me transferimin e pronësisë nga shteti tek komunat është e domosdoshme që procesi të vazhdojë edhe pas plotësimit të kuadrit ligjor. Kjo si pasojë e faktit që për sa i përket menaxhimit aktual të pyjeve është bërë shumë pak progres. Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve nuk kanë kapacitetet e duhura organizative e teknike për menaxhimin e pyjeve komunalë. Mungesa e kompetencave dhe mjeteve financiare sinjalizon që menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve nuk është ende i mundur në shumicën e rasteve.

Degradimi i tokës p.sh., nga erozioni është një tjetër problem. Në Shqipëri ky është një fakt i njohur jo vetëm në terrenet pyjore për edhe në tokat bujqësore. Afërsisht 123,000 ha janë toka të abandonuara (1997). Këto toka janë lënë jashtë vëmendjes dhe po degradohen gjithnjë e më tepër. Një tjetër aspekt është konsumi i druve të zjarrit për ngrohje e gatim në zonat rurale. Në këto zona jetojnë mbi 400,000 familje të cilat konsumojnë rreth 1.2 milion m<sup>3</sup> dru zjarri në vit, shumica e të cilave sigurohet nga prerjet e paligjshme në pyjet shtetërorë.

Sfidat kryesore në procesin e MPK janë si më poshtë (Lako 2008):

- ➔ Përmirësimi i politikave pyjore që lidhen me pylltarinë komunale për sa i përket çështjeve të pronësisë, sigurimit të të ardhurave, etj;

- ➔ Kuadri ligjor për transferimin e pyjeve në përdorim/pronësi komunave është ende i pa plotësuar;
- ➔ Mungesa e vullnetit të vendim-marrësve për ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësi për qeverisjen e pyjeve me DSHP
- ➔ Nuk ka ende një metodologji të miratuar për përcaktimin/shënimin e kufijve të burimeve natyrore sipas fshatrave/komunave;
- ➔ Shërbimi Pyjor vendos në mënyrë arbitrare për zonat pyjore që do tu transferohen fshatrave/komunave, pa marrë parasysh kufijtë tradicionalë dhe kërkesat e komunitetit .

Në Serbi dhe Maqedoni ndërmarrjet publike të pyjeve janë ngarkuar më një sërë detyrash teknike të menaxhimit të pyjeve privatë. Megjithatë, sipas shoqatave kombëtare të pyjeve privatë, organizimi aktual i shërbimeve teknike dhe ekstensionit për pyjet privatë dhe mungesa e një shërbimi të veçantë këshillimi nuk i kënaq nevojat e pronarëve privatë. Mangësia më e madhe e sistemit aktual të organizimit të detyrave profesionale e teknike në pyjet privatë është konflikti i pastër i interesit në Ndërmarrjet publike që kryejnë këto detyra. Meqë, detyra kryesore e ndërvarjeve publike të pyjeve është menaxhimi i pyjeve shtetërorë, menaxhimi i pyjeve privatë paraqet një burim konkurrence për ta. Realizimi i shërbimeve për pronarët e pyjeve privatë mund të shkaktojë konflikt interesi, pasi pylltarët shtetërorë nuk mund të jenë të pavarur në aktivitetet teknike të menaxhimit dhe të këshillojnë një konkurrent (Begus, 2006).

Meqenëse, në Serbi mungojnë planet e menaxhimit për pyjet privatë, pylltarët nuk kanë informacionin e mjaftueshëm mbi pronat/pyjet privatë, dhe si rrjedhojë nuk kanë një pamje të qartë të situatës, çka çon në një përjasje të papërshtatshme në menaxhimin e pyjeve privatë. Në Maqedoni, pronarët e pyjeve ankohen se planifikimi dhe praktikrat e menaxhimit të pyjeve privatë kanë qenë problemi më i rëndësishëm për pylltarinë private në 10 vitet e fundit.

Komunikimi midis pronarëve të pyjeve dhe pylltarëve funksionon kryesisht nga pylltarët të pronarët dhe kryesisht është mbi procedurat ligjore. Shërbimi i ekstensionit është i kufizuar pasi procedurat janë shumë të komplikuar. Një farë ekstensionit bëhet, kryesisht me shënimin e drurëve, por nuk është i koordinuar dhe i organizuar. Kështu, sipas Nonic et al. (2007), riorganizimi i shërbimeve teknike dhe profesionale dhe krijimi i një shërbimi këshillimor për pylltarinë private shihen si prioritet për përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori në Serbi. E njëjta gjë mund të thuhet fare mirë edhe për Maqedoninë.

Në Serbi edhe statusi kushtetues i pyjeve private është kundërshtues (kontroversal), pasi të drejtat e pronësisë shtetërore dhe private janë të njëjta dhe kanë të njëjtën mbrojtje ligjore, por ë gjitha burimet natyrore janë shpallur si “të mira publike” dhe si rrjedhim zotërohen nga shteti. Ky formulim nuk është në linjë me kuptimin modern të pronës private por më tepër sjell në mendje formulimet e mjegullta ligjore të socializmit me kuptim jo të qartë. Prona private duhet të jetë e para nga të gjitha të mirat e një personi apo organizate të caktuar, çka nuk do të thotë që interesi publik është automatikisht i përjashtuar. Për më tepër, mbështetja financiare, organizative apo me kapacitete njerëzore për pronarët e pyjeve privatë, në të dy vendet, sapo ka filluar së fundmi. Si pjesë e aktiviteteve të PKP dhe SKP është bërë goxha punë për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike të pyjeve dhe mbështetjen e shoqatave të pronarëve të pyjeve. Aktivitetet janë realizuar nëpërmjet seminareve dhe edukimit të pronarëve të pyjeve.

Problemet e rregulloreve kontradiktore, mbivendosjes së të drejtave dhe përgjegjësi të organizatave dhe konfliktet e interesit që vijnë nga veprimet pothuaj monopoliste ndaj pyjeve privatë, në fund të fundit shkaktojnë in-efiçencën në zbatimin e pylltarisë së qëndrueshme në pyjet privatë apo komunalë në Ballkanin Perëndimor. Këto çështje janë veçanërisht shokuese, duke ditur që pas pothuaj 20 vjet tranzicioni nga socializmi në sisteme demokratike në Ballkanin Perëndimor, marrëdhëniet e pushtetit midis aktorëve tradicionalë të pylltarisë janë pothuaj të pandryshuara. Më të fuqishmit janë administratat pyjore publike dhe ndërmarrjet shtetërore të pyjeve. Veprimet e pronarëve të pyjeve janë ende të paracaktuara nga organizatat publike të cilat nuk lenë hapësirën e nevojshme dhe mjetet financiare për mundësi zhvillimi. Kështu, pak është bërë nga ana e qeverisë për të ndihmuar pronarët e pyjeve dhe lejuar atyre një rol më të përshtatshëm dhe serioz në politikën pyjore (PRIFORT 2009).

Lidhur me këto probleme, autorë dhe organizata të ndryshme apo rezultate projektesh, kanë dalë me propozime të ndryshme zgjidhjesh. Në Serbi, rezultatet e projektit FAO TCP përfshijnë masat e mëposhtme (2007):

- ➔ Ri-përkufizimin e roleve dhe përgjegjësi dhe marrëdhënieve të brendshme të organizatave të sektorit me ndarje të qartë të funksioneve (ekzekutive, kontrolluese, mbështetëse dhe funksionin e pronësisë);
- ➔ Krijimin e institucioneve të reja – p.sh., Agjencia e Pyjeve ;<sup>11</sup>
- ➔ Përkufizimin e të drejtave dhe përgjegjësi të organizatave shtetërore të menaxhimit të pyjeve;
- ➔ Incentivat për organizimin e pronarëve të pyjeve privatë dhe menaxhimi i përbashkët i pyjeve, etj.

Reforma të tjera organizative, si krijimi i Agjencisë së Pyjeve dhe fuqizimi i organizatave të tjera të pylltarisë private varen nga miratimi i Ligjit të Pyjeve (Nonic 2007). Reforma të tjera si shërbimi për pyjet privatë brenda ndërmarrjeve publike të pyjeve varet nga ristrukturimi i brendshëm i NP i cili nuk ka filluar ende.

Tabela e mëposhtme përmbledh çështjet kritike dhe rekomandimet e identifikuara në Shqipëri nga Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunalë në 2006 (Lako 2008).

**TABELA 2: ÇËSHTJET KRITIKE DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E POLITIKAVE DHE LEGJISLACIONIT PËR PYJET NË SHQIPËRI (2006)**

Çështjet Kritike	Rekomandime / Propozime / Sugjerime
Mungesa e politikave të qarta e të përshtatshme për pronësinë e tokës dhe menaxhimin e pyjeve komunalë	Përgatitja e paketës për rregullimin e të drejtës së pronësisë në pyjet komunalë, dhe përmirësimi i akteve nënligjore për transferimin dhe menaxhimin e pyjeve komunalë.
Një ligj jo i përcaktuar mirë për pyjet komunalë (ligji aktual nuk fokusohet në çështjet kryesore të pylltarisë si pronësia dhe të drejtat e përdorimit, decentralizimi dhe delegimi i kompetencave)	Plotësimi i kuadrit ligjor për transferimin e pyjeve komunalë në pronësi të fshatrave dhe pushtetit vendor dhe menaxhimin i qëndrueshëm i tyre nga komunitetet lokale.
Një ligj jo i përcaktuar mirë për pyjet komunalë (ligji aktual nuk fokusohet në çështjet kryesore të pylltarisë si pronësia dhe të drejtat e përdorimit, decentralizimi dhe delegimi i kompetencave)	Përmirësimi i politikave pyjore për të stimuluar gjenerimin e të ardhurave nga pyjet komunalë përfshirë prodhimet e dyta pyjore, kafshët e egra, gjuetinë, et, dhe sigurimi i instrumenteve ligjore dhe institucionale për përdorimin e këtyre të ardhurave për përmirësimin e jetesës së komuniteteve;
Mungesa e të drejtave të përdoruesve për të gjeneruar të ardhura nga aktivitetet në pyjet komunalë.	Decentralizimi i vendim-marrjes për tarifat pyjore në nivelin e pushtetit vendor.
Mungesa e njohurive dhe transferimi i teknologjive.	Ngritja e një shërbimi këshillimor efektiv për pyjet komunalë.

*Burimi: Lako 2008*

Ngritja e kapaciteteve zbut disa nga problemet institucionale, teknike apo të sistemit administrative të përmendura më sipër.

Meqë shumica e vendeve kanë bërë shumë për reformimin e sektorit pyjor dhe ekonomisë në përgjithësi, por njëkohësisht përballen me konflikte interesash në këto reforma, ngritja e kapaciteteve është një ndikim afatmesëm ose afatgjatë. Në shumicën e vendeve të EJT, ngritja e kapaciteteve të aktorëve ka qenë pjesë e proceseve të përgjithshme të politikës pyjore të programeve kombëtare të pyjeve apo strategjisë kombëtare të pyjeve, apo kanë dalë nga perspektiva e një aktori të ri. Në disa raste, projektet e financuara nga ndërkombëtarët kanë pasur gjithashtu një ndikim në këtë drejtim.

Në procesin e Planit Kombëtar të Veprimit për Pyjet në Serbi, propozimet që lidhen me administratën pyjore dhe ekstensionin pyjor, adresojnë ngritjen e kapaciteteve të të dy institucioneve. Për grupe kyçe të inspektorëve dhe specialistëve të ekstensionit janë organizuar trajnime dhe udhëtime studimore. Gjithashtu, nëpërmjet intervistave janë identifikuar nevojat për trajnime të



pronarëve të pyjeve. Po ashtu, janë hartuar edhe planet e zgjerimit të Shërbimit të Inspektimit dhe Shërbimit për Pyjet Privatë brenda NP “Srbijašume” dhe Parkut Kombëtar Tara (Nonic, Milijic 2008). Kjo është hartuar duke përdorur metodologjinë e trajnimit të trajnerëve. Ajo përfshin metodat e pjesëmarrjes në pyje, ekstensionit dhe nxitjes së grupeve, si dhe disa shembuj të operacioneve konkrete pyjore kombinuar me zbatimin e ligjit duke siguruar një mënyrë më të hapur në përballimin e klientëve të administratës. Po ashtu janë adresuar, komunikimi me pronarët e pyjeve, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve të pyjeve, përfshirë pyjet e kishës, dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të pyjeve privatë. Si rezultat i procesit të ngritjes së kapaciteteve, u kualifikuan 13 kandidatë si trajnerë dhe 51 inspektorë dhe inxhinierë pyjesh morën pjesë në trajnimet e mëvonshme. Është planifikuar që ngritja e mëtejshme e kapaciteteve do të ndërmerret nga grupi kyç kombëtar dhe trajnerët e kualifikuar. Në një shkallë të vogël pilot, janë realizuar edhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve lidhur me NVM bazuar në pyje. Gjithashtu, dy NVM e para kanë regjistruar aktivitetet e tyre dhe kanë marrë fonde nga buxheti i shtetit. Planet e tyre të zhvillimit përdoren si material mësimor për oficerët e ekstensionit apo si udhëzues për zhvillimin e bizneseve.

Në Maqedoni, programet e edukimit në shkollat e mesme e të larta kanë filluar trajtimin e temave të “iniciativës private.” Për sa i përket pylltarisë, kjo do të bëhet nga shkolla e mesme pyjore në Kavadarci dhe nga Fakulteti i Pyjeve në Shkup. Fakulteti i ekonomisë dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, gjithashtu kanë filluar trajtimin e kësaj teme.

## 5: NDËRMARRJET E VOGLA NË SEKTORIN PYJOR TË DISA VENDEVE TË EJL

Spektori i NVM është shtylla kurrizore e zhvillimit ekonomik në shumë ekonomi tregu të vendeve të Evropës. Eksperiencat tregojnë se NVM kanë një ndikim thelbësor mbi prodhimin kombëtar dhe të ardhurat dhe një efekt relativisht të latë mbi punësimin, çka tregon se objektivat strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të sigurojnë përmirësimin e kushteve për to.

Në Serbi potenciali dhe rëndësia e sektorit të NVM janë njohur në dokumentet strategjike të planifikimit të pyjeve. Strategjia e Zhvillimit të Pyjeve të Republikës së Serbisë (2006) thekson nevojën e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme pyjore.

Objektivat kryesore për zhvillimin e NVM mbështetën nga një rritje e kontributit të sektorit pyjor në zhvillimin ekonomik dhe social në nivel kombëtar. Lidhur me masat direkte për nxitjen e aktivitetit të NVM në pyje dhe industrinë pyjore, është miratuar Strategjia për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe iniciativën private për periudhën 2003–2008. direktivat kryesore strategjike të kësaj strategjie janë:

- ➔ Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin primar,
- ➔ Mbështetja e institucioneve që lidhen me interesat e kompanive për zgjidhjen e kufizimeve ligjore,
- ➔ Masa financiare, edukative dhe trajnime, si nxitja e eksportit, analiza e sektorit dhe masa të mbështetjes teknike

Pylltaria dhe NVM bazuar në pyje shihen si potencial i madh për të ndihmuar rikuperimin e ekonomisë kombëtare.

Në Serbi, sot janë rreth 3000 ndërmarrje të vogla e të mesme që bazohen në pyje. 98% e tyre janë ndërmarrje të vogla/mikro. Ato kanë lulëzuar falë procesit të privatizimit në Ndërmarrjen Publike të Menaxhimit të Pyjeve “Srbijašume” (NPMP) që nga 2001. në të njëjtën kohë rreth 400 NVM nënshkruajnë kontrata vjetore me NPMP dhe sigurojnë shërbime lidhur me prerjen, nxjerrjen dhe transportin e asortimenteve drunore, si dhe me ndërhyrjet silvikulturore. Në sigurimin e shërbimeve për pyjet shtetërorë NVM marrin pjesë me 88% në prerjen e drurëve, 77% në nxjerrjen dhe 70% në transportin e brendshëm të materialit drunor. Në tre vitet e fundit 70 NVM të ndryshme janë angazhuar në punime silvikulturore, 227 në shfrytëzimin dhe transportin e brendshëm dhe 193 në transportin e lëndës drusore dhe ndërtimin e rrugëve/pistave të shfrytëzimit.<sup>12</sup> Vetëm 16 NVM merren më fidanishtet pyjore dhe prodhimin e fidanëve. Ky biznes është paksa i pa zhvilluar ndërmjet ndërmarrjeve private, duke dhënë vetëm 2% të prodhimit total.

Shumica e NVM në sektorin e pyjeve janë me bazë familjare apo mikro-ndërmarrje me asete që përmbledhen në një kamion dhe pajisje shfrytëzimi. Për shembull, një prodhues qymyri mund të operojë zakonisht 2–7 kamina. Ai mund të zotërojë një kamion dhe mund të blejë dru apo edhe qymyr nga prodhues të tjerë me qëllim furnizimin e tregjeve më të mëdha. Ekzistojnë shumë pronarë pyjesh privatë që jetojnë me të ardhurat e gjeneruara nga pyjet e tyre. Nonic & Milijic (2008) i referohen gjithashtu edhe sfidës së numrit të madh të ndërmarrjeve konkurruese që kryejnë shpesh aktivitete të pa regjistruara, si p.sh., gatra apo kamina të paregjistruara. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se zakonisht ato punësojnë punëtorë të pakualifikuar, pa arsimin e duhur, pa trajnim specifik në menaxhimin e pyjeve apo licenca për përdorimin e makinerive.

Për sa i përket aktiviteteve të tjera në pyje, në serbi ka NVM të regjistruara për:

- ➔ Grumbullimin dhe përpunimin e prodhimeve të dyta pyjore (qymyr, bimë mjekësore, terpeninë, fruta pylli, mjaltë, etj);
- ➔ Shërbime turistike dhe rekreative;
- ➔ Gjueti dhe peshkim.

NVM në Serbi raportojnë për akses të vështirë në kapitalet për investime në përmirësimin e teknologjisë dhe teknologjinë e informacionit apo edhe mungesë të kapitalit operacional. më shumë kapital, teknologji dhe informacion do të lejojë për shfrytëzimin dhe blerjen në “shitjet mbi cung” si dhe për sigurimin e lëndëve të para si nga pyjet privatë edhe ata shtetërorë, çka nuk ndodh aktualisht.

Për më tepër, përqasja e NP “Srbijašume” për të paguar për shërbimet me produkte drusore të cilësisë së ulët, si dru zjarri he mbeturina kanë krijuar probleme afatgjatë për NVM. Kjo praktikë minon zbatimin e shërbimit si dhe pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve mbi kontraktorët. Ajo redukton likuiditetet, bind disa nga ndërmarrjet që të bazojnë bizneset e tyre në prodhimin e qymyrit, lënda e parë për të cilin vjen nga drutë e dhëna si kompensim për shërbimet e kryera.

Një nga disavantazhet më të mëdha ndaj NVM është shkalla e lartë e fragmentimit në pyjet e Serbisë. Megjithëse pronarët e pyjeve privatë zotërojnë pothuajse gjysmën e burimeve pyjore, vetëm 20–30% e prodhimit të tyre konsiston në trupa për industrinë dhe pjesa tjetër është shumica dru zjarri (Salmi 2006). Në shumicën e rasteve pyjet privatë janë në forma të çrregullt, në rripa të gjatë e të ngushtë, si rezultat i ndërprerjeve të vazhdueshme si rezultat i praktikave të trashëgimisë. Aktualisht, më tepër se 90% e pyjeve privatë kanë nevojë për plane menaxhimi të përshtatshme. Efektet e akumuluar të mungesës së planeve të menaxhimit dhe zbatimit të tyre për pyjet privatë evidentohen nga degradimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe aftësisë prodhuese në shumicën e këtyre pyjeve. Për më tepër, edhe pse kadastra pyjore fillon që më 1930, shënimi i kufijve të pyjeve nuk është i plotë dhe nga 50'000 km kufij pyjorë, vetëm 15'000 km janë shënuar deri tani. Kompletimi i pjesës së mbetur të kufijve është një operacion i kushtueshëm, megjithëse ndërkohë që mungesa e kufijve mund të çojë në konflikte midis administratës pyjore, PPP dhe komuniteteve lokale (Kir 2003).

Si pasojë e rrethanave ekonomike në Serbi, kapacitete të ulëta për iniciativa private dhe nivel i ulët i arsimimit dhe sens menaxhimi, NVM në pyje normalisht nuk përdorin apo nuk kanë akses ndaj kredive apo huave bankare. Shumica e NVM përmendin që përqindjet e interesit janë ende shumë të larta. Nga ana tjetër, bankat zakonisht hezitojnë të japin hua për prodhues shumë të vegjël pyjorë meqë prodhimi nuk është i dukshëm për ta dhe i lidhur me një sërë variablash për të pasur sukses në tregtim dhe siguruar operacione fitimprurëse. Për më tepër, prodhuesit pyjorë nuk janë të organizuar dhe kanë një kapacitet të ulët të sipërmarrjes private. Të nëntë pronarët apo menaxherët e NVM të intervistuar gjatë studimit “Majdanpek key study” (FORNET 2009) konfirmuan se vështirësitë në investime dhe mungesa e kapitalit janë kufizimet kryesore që lidhen ngushtë me bizneset e tyre. Megjithatë, ka një sërë programesh për grante dhe kredi në kuadër të Departamentit të Zhvillimit Rural të MBUMU të financuar nga BE. Programet e granteve janë për organizatat apo firmat rurale të regjistruara dhe është përcaktuar që përfituesit duhet të sigurojnë një bashkëfinancim prej 40%. Kur bëhet fjalë për programet e huave, ekzistojnë një sërë bankash kooperuese që kanë interesa të ulëta për huat (4%) për klientët në këmbim të një garancie të lëshuar nga një fond besimi i Departamentit. NVM përmendin se ato dinë shumë pak mbi këto mundësi dhe Departamenti i Zhvillimit

Rural duhet të ketë më shumë informacion transparent dhe shpërndarje më të mirë të këtij informacioni. Milijic thekson (2008) se një nga problemet strukturore në këtë kuadër është mos përcaktimi i roleve dhe modeleve të partneritetit të sektorit privat e publik në financimin e NVM dhe mungesa e komunikimit të duhur dhe shkëmbimi i informacionit midis Qeverisë dhe sektorit privat. Kjo pjesërisht vjen si pasojë e faktit që institucionet e ngarkuara më këtë detyrë, janë krijuar sipas një modeli të marrë nga periudha socialiste. Këto institucione fillimisht u krijuan për të kryer shërbime për ndërmarrjet e mëdha shtetërore dhe kështu, tani u duhet të përballen me rregullimin e vetes ndaj kushteve të ekonomisë së tregut dhe klientëve të rinj, në këtë rast NVM.<sup>13</sup>

Shifrat mbi NVM e lidhura me pyjet në Maqedoni (2004) paraqiten në tabelën 3.

**TABELA 3: NUMRI I NVM TË REGJISTRUARA TË SEKTORIT PYJOR**

Sektori	Vogla	Mesme	Mëdha	TOTALI
Bujqësi, pyje dhe gjueti	912	31	3	946
Peshkim	28	0	0	28

*Burimi: Central Register Office of Macedonia, 2004*

Shumica e NVM të bazuar në bujqësi dhe pyje janë ndërmarrje të vogla apo shumë të vogla (biznes familjar). Fatkeqësisht, të dhënat për pylltarinë, gjuetinë dhe bujqësinë nuk janë të ndara. Fushat e tyre të biznesit mbulojnë sharrat, briketimin, përpunimin e prodhimeve të dyta pyjore dhe eko-turizmin.

Sipas Dhomës së Ekonomisë së Maqedonisë, ekzistojnë rreth 590 kompani të përpunimit primar (shara) dhe 566 kompani për përpunimin përfundimtar (Dhoma e Ekonomisë e Maqedonisë 2006). Në të njëjtën kohë ka edhe disa të dhëna për kompanitë e sharrave, paneleve më bazë drusore, prodhimin të letrës dhe kartonit (Tabela 4).

**TABELA 4: STRUKTURA E NDËRMARRJEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË 2003**

	Madhësia e ndërmarrjes	Prodhimi bruto në Euro	Numri i ndërmarrjeve
Sharra	vogël	13,556	549
	mesme	969	3
Panele me bazë drusore	vogël	477	10
	mesme	0	0
Letër dhe karton	vogël	15,298	189
	mesme	3,303	2
	mëdha	10,171	1

*Burimi: Economic Chamber of Macedonia, 2003*

Këto ndërmarrje normalisht janë në pronësi private dhe funksionojnë si kompani me kapital të përbashkët apo ShPK. Shumë prej tyre nxjerrin disa fitime, por shumica janë të pajisur me teknologji të vjetër, dhe shpesh mungon marketingu apo dizajnim modern e si rrjedhim nuk mund të pretendojnë për konkurrencë të fortë në tregjet ndërkombëtare.

Në pyje, ndërmarrjet e vogla private lindën si rezultat i ndryshimeve politike si dhe reformimit të organizatës shtetërore të menaxhimit të pyjeve (Makedonski Sumi). Në vitin 1999/2000 ndërmarrja publike privatizoi disa nga aktivitetet e saj kryesore si prerjen, transportin e brendshëm dhe transportin e lëndës drusore. Kjo masë rriti ndjeshëm numrin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme lidhur me pyjet. Për momentin, janë rreth 480 NVM që lidhen me aktivitetet e NP “Macedonian Forests” nëpërmjet tenderëve të hapur. Ato sigurojnë shërbime që arrijnë sasi të mëposhtme vjetore: dru zjarri 450,551m<sup>3</sup>, trupa—144,600 m<sup>3</sup> (75% fletorë, 25% halorë). Për operacionet e mësipërme, janë të punësuar rreth 1000 njerëz në këto NVM (Stojanovska 2009).

Më tej, në 2005, njësi të tjera të kompanisë u shndërruan në kompani private për të reduktuar numrin e punonjësve. 7 sharra, 1 njësi peshkimi dhe një pjesë për prodhimin e kërpudhave u shkëputën nga NP “Macedonian Forests” dhe u transformuan në ndërmarrje të vogla e të mesme private.

Gjithashtu, në ndjekje të tendencave të bioenergjisë, shumë fabrika të përpunim drurit, p.sh, sharrat, kanë futur në përdorim makineritë e briketimit në zinxhirin e tyre të prodhimit. Megjithatë, vetëm 6–7 kompani në vend kanë një profil të pastër për prodhimin e briketave, duke prodhuar si për tregun vendas ashtu edhe për tregjet Evropiane.

Maqedonia, ka gjithashtu burime të rëndësishme për prodhimet e dyta pyjore, p.sh, bimë mjekësore, kërpudha, fruta pylli, kullota dhe lloje të ndryshme gjahu, të cilat mund të përdoren nga NVM të specializuara në grumbullimin dhe përpunimin e tyre.

Në Maqedoni ka rreth 2’800 lloje kërpudhash, 50 prej të cilave grumbullohen zakonisht për përpunim të mëtejshëm apo shitje. Ato duket sikur kanë një vlerë të jashtëzakonshme ekonomike për popullatat lokale në zonat rurale. Të dhënat mbi vlerat e eksportit tregojnë për një vëllim prej 328’693 kg me një vlerë të llogaritur prej rreth 2 milionë USD (State Statistics, 2001). Ndërmarrjet blerëse kanë një kontratë vjetore me një vlerë të specifikuar me ndërmarrjen publike “Makedonski Sumi” apo me parqet kombëtare. Megjithatë, grumbullimi individual nuk është rregulluar në asnjë mënyrë dhe nuk ka të dhëna të regjistruara mbi sasinë totale të kërpudhave të grumbulluara. Gjithashtu, licencat për eksportimin e llojeve komerciale mund të merren nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit (MMPT) por nuk ka të dhëna të tjera lokale apo rajonale. Kështu, asnjë nga aspektet e qëndrueshmërisë nuk mund të vlerësohet për momentin dhe as nuk janë parashikuar kufizime për grumbullimin, me përjashtim të listës së llojeve të mbrojtura.

Ka një spektër të gjerë bimësh që grumbullohen lirisht, që përdoren për përgatitjen e çajeve dhe erëzave. Në këtë fushë janë aktive disa kompani të specializuara si Alkaloid-Skopje, Jaka-Radovis, por edhe grumbullimi individual vlerësohet si i rëndësishëm. Sasia e eksportuar e bimëve për çaj ishte 1’127’825 kg në 2001 me një vlerë prej 1’43’052 USD. Megjithatë, disa të dhëna vjetore të viteve më parë përmendin vlera prej 4.5–5 milion USD (State Statistics 2008).

**Frutat e pyllit dhe arrorët** janë kryesisht produkte malore, ku ndër më të rëndësishmet është boronica (*Vaccinium myrtillus*), një produkt përdorur kryesisht për eksport. Të dhënat e 2001 specifikojnë vlera të eksportit me një vëllim prej 83’284 kg me një vlerë prej 86’196 USD. Të dhënat gjithashtu specifikojnë afërsisht 250’000 kg gështenja të grumbulluara çdo vit dhe kryesisht të përdorura apo tregtuara në vend.

Numri i grumbulluesve vlerësohet në rreth 12’000 njerëz (USAID, 2008). Këto të dhëna dalin nga sasitë e blera nga kompanitë dhe sasitë e eksportuara, me disa mesatarizime për sasitë e grumbulluara të kërpudhave, likeneve, frutave dhe produkteve të tjera. Numri i grumbulluesve është në rritje. Edhe pse grumbullimi është një aktivitet tradicional i popullatave që jetojnë pranë pyjeve, ai u reduktua mjaft gjatë fazës së industrializimit të Maqedonisë. Grumbullimi rifilloi sërish pasi tregu kërkonte sasi të mëdha pas blerjeve të fuqishme të produkteve në fillim të viteve 1990. Shumë njerëz në moshë të mesme apo të moshuar, të papunë, dalë nga kompanitë e mëdha të falimentuara, u morën me grumbullimin e këtyre prodhimeve. Nën presionin e varfërisë së madhe dhe mundësive të kufizuara të punësimit, zonat e malore të Maqedonisë vazhdojnë traditën e tyre të grumbullimit. Afërsisht janë 80 kompani grumbullimi dhe rreth 100 tregtarë të tjerë të pavarur e të peregjistruar.

Në Maqedoni, përpunimi është organizuar nga rreth 20–30 kompani, ku vlerësimet tregojnë se ka rreth 600 persona të punësuar të përhershëm. Kompanitë angazhojnë rreth 3000 persona të tjerë në përpunim gjatë sezonit. Kompanitë e përpunimit organizojnë eksportin e produkteve. Si panoramë e përgjithshme, rreth 20’000 familje në Maqedoni kanë lidhje të rregullta me këtë sektor, qoftë edhe sezonale.

Nuk mund të shihet ndonjë lidhje e qartë e këtyre mikro ndërmarrjeve apo aktiviteteve të peregjistruara me pyjet privatë. Meqë pyjet privatë janë të vogla, mesatarisht të fragmentuara në një numër të shpërndarë parcelash kadastrale, të lidhur me disa vështirësi administrative menaxhimi, shumica e pronarëve privatë të pyjeve i përdorin pyjet për prodhimin e druve të zjarrit apo përdorime të tjera vetjake që përgjithësisht janë të peregjistruara. Kjo nënkupton që pronarët e pyjeve pothuajse nuk kanë

produkte të tregtueshme që ia vlejné për të ngritur një biznes mbi to apo investuar në to. Megjithatë, të drejtat e pronësisë luanë një rol qendror, pasi as grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore as gjuetia për shembull nuk është rregulluar në mënyrë që pronari i pyjeve të ketë ndonjë shans për të zhvilluar biznes me produktet që zotëron.

## 6: PËRMBLEDHJE E SITUATËS SË NVM DHE INVESTIMEVE BAZUAR NË EKSPERIENCAT E VENDEVE TË PËRZGJEDHURA

Në përfundim, është e qartë që në Evropën Jug-Lindore dhe Ballkanin Perëndimor, pylltaria jo shtetërore është përgjithësisht ende pak e zhvilluar dhe në nevojë për përmirësimin e politikave apo reformave, investime dhe ngritje kapacitësh. Pronarët e pyjeve privatë dhe komunalë kanë vështirësi për të marrë pjesë si duhet në përcaktimin e politikave në nivel kombëtar dhe ndër-sektorial si p.sh, zbatimi i programi kombëtar të pyjeve. Ky është rasti edhe në Shqipëri e Maqedoni, edhe pse atje ekzistojnë organizata të pronarëve të pyjeve në nivel kombëtar për përfaqësimin e interesave të tyre. (2008). Megjithatë, vitet e fundit është bërë progres mbi këto çështje në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Përgjithësisht, mund të thuhet se pronësia jo shtetërore në vendet e EJL përballet me probleme të njëjta të kuadrit jo mbështetës politik dhe financiar për funksionimin e duhur të saj. Kjo është pjesërisht trashëgimi nga praktikat ligjore të kohës së socializmit, p.sh, ish-Jugosllavja, ku pronësia private mbi pyjet ishte ligjërisht e mundur por praktikisht dhe nga pikëpamja menaxheriale tepër e kufizuar. Nuk ekzistonin as organizatat e pronarëve të pyjeve. Në Shqipëri nuk lejohej as prona private gjatë regjimit socialist. Pas ndryshimeve politike të 15 viteve të fundit, rikthimi i pronave ka ecur përpara por shumica e vendeve të EJL kanë kapërcyer fare pak ose aspak kushtet e pafavorshme në reformat organizative, konfliktet e përgjegjësi dhe problemet e mbështetjes financiare. Për këtë, është vënë re një zhvillim i dobët i pylltarisë jo shtetërore. Si rrjedhim, pronarët e pyjeve janë ende pak të organizuar apo përfaqësimi i tyre është krahasimisht i ulët në ato pak organizata ekzistuese dhe potenciali i tyre social-ekonomik nuk është eksploruar ende.

Problemet më serioze të ndërmarrjeve dhe sipërmarrësve janë pjesërisht të natyrës teknike lidhur me pajisje dhe makineri të vjetërsuara, por çfarë është më shqetësuese është situata e pafavorshme e financiare me huat e shtrenjta tregtare dhe mungesën e incentivave për modernizimin dhe zhvillimin e fondeve të NVM si dhe infrastruktura e dobët. Krahu i pakualifikuar i punës pengon seriozisht zhvillimin e sipërmarrjeve, pasi atij i mungon jo vetëm iniciativa por edhe një sërë aftësish të ndryshme. Përgjithësisht dobësitë dhe problemet e NVM përfshijnë: a) mungesën e mundësive të biznesit për vetëfinansim si pasojë e nivelit të ulët të kapitalit operacional disponibël, b) aktivitete të kufizuara investimi të sektorit financiar në bizneset pyjore, c) mungesa e informacionit mbi mundësitë financiare ekzistuese.

Nga ana tjetër, pika të forta të NVM në sektorin e pyjeve dhe industrinë e drurit janë p.sh, bashkëpunimi i vendosur me kompanitë shtetërore të menaxhimit duke krijuar një kërkesë dhe treg të qëndrueshëm në nivel lokal. Kjo lidhje gjithashtu çon në pjesëmarrje thelbësore në krijimin e zinxhirit të vlerave për produktet drusore e jo drusore. Ndryshimet e tregut mund të ndiqen më me shpejtësi dhe kontributi në zhvillimin rural me mbështetje reale politike dhe financiare është në vendet e para të agjendës Evropiane për vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE. Megjithatë, disponibiliteti i burimeve të pyjeve privatë/komunalë ndryshon shumë midis vendeve, pasi p.sh, në Serbi, Kroaci dhe Shqipëri është i konsiderueshëm, ndërsa në vende të tjera si Maqedonia apo Mali i zi ai është më i kufizuar.

Megjithatë, realizimi i këtij potenciali kushtëzohet nga ekzistenca e një kuadri mbështetës në njërën anë, dhe bashkëpunimit të tyre në anën tjetër. Me qëllim mobilizimin e pronarëve të pyjeve privatë është e nevojshme të intensifikohen aktivitetet e organizatave të tyre dhe të vendosen lidhje me pushtetin vendor, organizatat cluster dhe shoqatat e sipërmarrësve dhe tregtarëve.

Kërcënimi kryesor për zhvillimin e NVM pyjore në EJL janë ndryshimet e shpeshta në kushtet e biznesit si rregulloret financiare, taksat dhe tarifet, si dhe ndryshimet në kushtet e tregtisë dhe eksportit. Gjithashtu, kërcënim i madh për eksportuesit janë kurset e paqëndrueshme të këmbimit dhe mungesa e një politike bindëse zhvillimi, konkurrenca e pandershme nga ekonomia "gri"/ informale, dhe shtrenjtësia dhe pambërritshmëria e kapitaleve investuese.

Në industrinë e përpunimit drurit ekzistojnë mundësi për diversifikimin e produkteve, nisur nga zgjerimi p.sh, i sektorit të ndërtimit në Mal të zi dhe nivelin e lartë të produkteve përfundimtare drusore të importuara. Orientimi drejt tregut dhe produktit janë të një rëndësie themelore. Aftësitë për planifikimin e biznesit janë mjaft të rëndësishme kur flitet për projekte dhe vlerësime investimesh.

Në ekonominë e zhvilluara, financimi me kredi realizohet kryesisht mbi baza komerciale nëpërmjet bankave tregtare. Në Maqedoni financimi i NVM është bërë më transparent së fundmi, duke bërë që termat e kredive të jenë më të aksesueshme për sipërmarrësit në përgjithësi. Megjithatë, në shumicën e rasteve, bankat nuk e kanë ndërmarrë rrezikun kur vjen puna për financimin e NVM (Stojanovska 2009). Bankat kanë raportuar problemet e mëposhtme si më të rëndësishmet lidhur me dhënien e huave ndaj NVM:

- ➔ Analizat e riskut vlerësojnë vlera dhe probabilitet shumë të mëdha risku;
- ➔ Mungesa e sigurisë (kolateral) dhënë nga NVM;
- ➔ Përqindje e vogël e kredive të kthyera nga NVM si pasojë e shpenzimeve të mëdha operative;
- ➔ Mungesa e aftësive menaxheriale dhe sipërmarrëse;
- ➔ Raporte të varfra financiare që e bëjnë të vështirë vlerësimin financiar të ndërmarrjeve;
- ➔ Strategji të papërshtatshme të bankave për kreditë që nuk janë në përputhje me nevojat e NVM.

Mundësitë në dispozicion të NVM varen mjaft nga huatë qeveritare apo programet financiare ndërkombëtare siguruar nga PHARE (BE), IFAD (OKB), Fondi i NVM (USAID), Fondi i Zhvillimit Ekonomik (SOROS), Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Fondet e NVM nga Qeveritë e Italisë, Gjermanisë, dhe Holandës, kredi eksporti për NVM. Vlera totale e këtyre programeve arrin në 96 milionë Euro të ndara dhe planifikuara për qëllime të ndryshme, por ajo jep magnitudën në dispozicion për zhvillimin e NVM në përgjithësi në Maqedoni.<sup>14</sup> Megjithatë, NVM lidhur me pyjet shpesh ose janë jo të përshtatshme ose jo të suksesshme në lobimin ndaj këtyre programeve financiare qeveritare apo ndërkombëtare për financimin e NVM. Kjo situatë e pafat lidhet përgjithësisht me vendet e ELQ dhe jo vetëm me sektorin privat të pyjeve në EJL.

Në Maqedoni, në 2005 është krijuar Agjencia për Sipërmarrjen (APERM), me përgjegjësinë për të realizuar Projektet dhe Programet e Qeverisë si dhe projekte të tjera mbështetur nga donatorë të jashtëm. Agjencia aplikon për projekte nëpërmjet qendrave rajonale. Veç kësaj, janë edhe 7 të ashtuquajtura inkubatorë biznesi në Ohër, Delcevo, Makedonska Kamenica, Stip, Prilep, Strumica dhe Veles. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe atë të Bujqësisë në Shkup dhe në Fakultetin e Teknologjisë në Bitola janë krijuar tre agjenci për zhvillimin teknologjik. Kompanitë e sektorit privat kanë krijuar dhoma të reja dhe organizime sektoriale të cilat kanë zgjeruar shërbimet e ofruara nga NVM. Mbështetje e mëtejshme është dhënë në formën e trajnimeve dhe seminareve organizuar nga APERM dhe realizuar nga qendrat rajonale. Ato mbulojnë shumicën e shërbimeve në fushën e menaxhimit bazë, marketingut dhe kontabilitetit. Programi i biletave (voucher) për shërbime konsulence është zbatuar me qëllim të ndihmës sipërmarrësit që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje në menaxhimin e sipërmarrjeve të tyre.

Në përgjithësi, masat e ndërmarra për mbështetjen jo-financiare të ofruar ndihmojnë sipërmarrësit të përmirësojnë dhe forcojnë aftësitë e menaxhimit të bizneseve të tyre për të rritur konkurrueshmërinë. Në këto aktivitete ndërmarrjet pyjore kanë mundësi të marrin pjesë por nuk ka të dhëna specifike mbi pjesëmarrjen e tyre.

Input specifik sigurohet edhe nga aktivitetet me financim ndërkombëtar. Për shembull në vitet 2000 dhe 2001 kanë qenë 30 projekte në zbatim vetëm në Maqedoni lidhur me zhvillimin dhe menaxhimin e NVM. Këto projekte pjesërisht kanë adresuar shërbimet financiare, si kreditë, investimet dhe grantet, dhe pjesërisht kanë siguruar trajnime, asistencë teknike, fushata dhe shërbime konsulence (Stojanovska et al. 2009). Programi i Stimulimit të Sipërmarrjeve në Maqedoni (ESP), sponsorizuar nga



Agjencia Zvicerane e Zhvillimit me një buxhet total prej 3 milion CHF për tre vjet, dhe Programi për Zhvillimin e Sipërmarrjeve, Konkurrencës dhe Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme për periudhën 2007–2010, duket se janë dy programet më të rëndësishme për këtë studim. Programet do të zbatohen nga Departamenti i Sipërmarrjeve dhe Konkurrencës në Ministrinë e Ekonomisë dhe Këshilli Kombëtar I Sipërmarrjeve dhe Konkurrencës, si dhe nga ministritë e tjera.

Përgatitja e ndërhyrjeve për zhvillimin e Shërbimeve për Zhvillimin e Biznesit për NVM pyjore kërkon njohjen e situatës dhe tregjeve ekzistuese. Ajo gjithashtu nënkupton identifikimin e dobësive dhe mundësive në kërkesat për sigurimin e këtyre shërbimeve. Kjo njohje mund të ndihmojë në: a) identifikimin e mekanizmave lokalë të shërbimeve dhe pagesave; b) zgjedhjen e strategjisë dhe instrumenteve për ndërhyrje; c) identifikimin e institucioneve dhe rrjeteve lokale. Si rezultat i këtyre aktiviteteve kërkesa për Shërbime për Zhvillimin e Biznesit në përgjithësi dhe ato pyjore në veçanti do të rritet.

Duke pasur parasysh këtë, nevojat e NVM pyjore janë:

- ➔ Përmirësimi i aksesit nga financimeve;
- ➔ Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e bizneseve dhe analizën e tregjeve;
- ➔ Mbështetje për ofruesit e shërbimeve për të përmirësuar pajisjet e tyre nëpërmjet opsioneve të financimit, informacionit, trajnimeve etj;
- ➔ Krijimi i shërbimeve këshillimore për të siguruar furnizime të qëndrueshme me lëndë të parë;
- ➔ Sigurimi i informacionit mbi tregjet e reja ekzistuese dhe potenciale, përmirësimin e pajisjeve dhe mënyrat se si të regjistrojnë bizneset e tyre

NVM pyjore apo të lidhura me pyjet ekzistojnë kryesisht në sharra, briketim, përpunim i prodhimeve të dyta pyjore dhe operatione shfrytëzimi/transporti. Lidhja e biznesit e këtyre NVM me pyjet private e komunale të EJL pothuajse mungon tërësisht.

## 7: PËRFUNDIME

Është e dukshme që në EJL ka nevojë për një përjasje të koordinuar për përmirësimin e pylltarisë në shkallë të vogël.

Këtu, investimet duhet të mbulojnë jo vetëm vështirësitë apo problemet financiare por duhet të adresojnë gjithashtu: a) ngritjen e kapaciteteve dhe b) kushtet e kuadrit politik, si legjislacioni dhe korniza institucionale lidhur me pylltarinë në shkallë të vogël.

Në anën tjetër, ndryshimet bazë institucionale kërkojnë një incentivë të fortë politike kudo. Pylltaria në shkallë të vogël nuk ka qenë një prioritet deri tani në politikat pyjore apo ekonomike/NVM në shumicën e vendeve të EJL. Zhvillimi i politikave në EJL së fundmi ka aplikuar instrumente moderne në hartimin e politikave si programet kombëtare të pyjeve apo programet e zhvillimit të biznesit që adresojnë sektorin pyjor apo sektorin e NVM në përgjithësi. Si rrjedhojë e elementëve modernë të politikave, si pjesëmarrja e aktorëve apo koordinimi ndër-sektorial, është trajtuar në këto procese dhe dokumente edhe pylltaria private. Mund të thuhet që kjo çështje ka marrë më shumë vëmendje nga çfarë ka pasur më parë në shumicën e vendeve të EJL. Pa dyshim, ky zhvillim është fuqizuar ndjeshëm nga kushtet e reja të pronësisë dhe politikës demokratike, duke bërë që pylltaria private të ketë tashmë një zë në nivel kombëtar.

Megjithatë, përveç Kroacisë, ku është realizuar një reformë thelbësore e administratës së pyjeve private dhe rregulloreve të financimit, pak është arritur në këtë drejtim në pjesën tjetër të vendeve.

Një përjasje gjithëpërfshirëse ndaj çështjes së investimeve është vështirë të pritët kur vjen puna tek zbatimi i dokumenteve kombëtare të politikës pyjore në çështjet e pylltarisë private apo komunale. Legjislacioni i ri në Maqedoni dhe Serbi do të adresojë reformat administrative në pyjet private. Megjithatë, kjo nuk është ende e dukshme dhe me siguri nuk do të sqarojë gjithë kontradiktat në legjislacion mbi të zbatimin e të drejtave të pronësisë në pyjet private. Sidoqoftë zhvillimi i mëtejshëm është sigurisht i mundur.

Ngritja e kapaciteteve duket të jetë thelbësore në pylltarinë private dhe komunale në E.J.L pasi aktivitetet e biznesit në përgjithësi nuk janë të zhvilluara dhe kërkojnë më shumë aftësi për të qenë të suksesshëm e të qëndrueshëm. Lidhur me këtë, janë bërë një sërë aktivitetesh.

Që kanë adresuar aktorë të ndryshëm në pylltari. Për pylltarinë private duket të jetë thelbësore që pronarët e organizuar të jenë të dukshëm dhe të marrin asistencë. Kjo është më efektive nëse organizatat e tyre sigurojnë shërbime këshillimi, derisa kompanitë e shërbimit nuk janë ende aktive. Ky aspekt kërkon ngritjen e kapaciteteve organizative p.sh, shoqatat e pronarëve privatë të pyjeve të jenë agjentë për pronarët e pyjeve gjatë lobimit për politikën apo menaxhimin.

Megjithatë, çështja më e vështirë duket të jetë ndërtimi i besimit në sektorin financiar për sektorin e pazhvilluar të pylltarisë private apo komunale si fushë biznesi. Ende duhet shumë punë për të përmirësuar lidhjet e biznesit në pylltarinë private.

Sidoqoftë, ky dokument nuk mund të japë përgjigje se cili nga këto tre aspekte ka një prioritet më të lartë pasi ata janë të lidhur ngushtë e të ndërvarur nga njëri tjetri.

Ndoshta Dialogu mund të sjellë sqarime të mëtejshme në këtë dilemë dhe të sigurojë jo vetëm shkëmbime por edhe krijimin e një vizioni problemin e investimeve për pylltarinë private dhe komunale në E.J.L.

## ENDNOTES

- 1 Dr. Stojanovska Makedonka, Asistent Profesor, Fakulteti i Pyjeve, Shkup, Maqedoni
- 2 Mr. Nenad Petrovic, Asistent Kërkimesh, Fakulteti i Pyjeve, Beograd, Serbi
- 3 Dr. Atilla Lengyel, Këshilltar për politikën EQL, Konfederata Evropiane e Pronarëve të Pyjeve
- 4 Evropa jug-lindore referohet kwtu nw sensin e rajoneve tw raportimit tw KMMPEdhe pwr bwet nga Shqipwria, Bosnia dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Greqia, Mali i zi, Moldavia, Rumania, Serbia, IRJ e Maqedonisw, Turqia (MCPFE 2007).
- 5 Shifrat i referohen pyjeve tw inventarizuar, pa pwrshirw tw ashtuquajturit pyje tw hapur tw cilwt zwnw rreth 557,000 ha (National Forest Inventory, 2004).
- 6 Burimet zyrtare tw informacionit mbi pyjet japin shifra tw ndryshme mbi sipwfaqen pyjore. Wshtw e qartw qw nuk ka tw dhwna tw mjaftueshme as pwr pyjet privatw. Stretgjia pwr Zhvillimin e qwndrueshwm tw Pyjeve planifikon tw sheshojw çwshtjen e statistikave jo tw besueshme nw pyje (2005) (Trendafilov et al. 2008).
- 7 “...nw vend tw opsioneve tw menaxhimit aktiv tw pyjeve , pronarwt e pyjeve janw vwnw nw rolin e pwrdruesit pasiv tw shwrbimeve tw siguruara nga shwrbimet publike tw bashkive e komunave pwr cdo lloj mase pwr menaxhimin e pyjeve, shwnimin e drurwe dhe damkimin” (Damjanovic, 1986).
- 8 Ligji pwr pyjet i 1991 futi termin “*detyra teknike dhe profesionale*” nw pyjet privatw. Kjo lidhet me 1) lwshimin e licensave tw shfrytwzimit pronarwe tw pyjeve, 2)shwnimin e drurwe nw pyjet privatw, 3) lwshimin e lejeve tw transportit pwr lwndwn dhe drutw e zjarrit pwr pronarwt, 4) organizimin e aktiviteve pwr mbrojtjen e pyjeve nw pyjet privatw.
- 9 Çdo pronar pylli qw kryen shfrytwzimin e pyllit tw tij wshtw i detyruar tw paguajw njw tarifw shwrbimi prej 3% tw vlerws komerciale tw trupave tw shitur. Tarifa i paguhet Ndwrmmarrjes Publike Srbijasume dhe shkon nw buxhetin e shtetit. Nga ky burim, do tw financohen masat silvikulturore dhe mbrojtwe nw pyje. Megjithatw, deri mw tani nga ky burim janw finacuar vetwm masat nw pyjet shtetwrorw.

- <sup>10</sup> Politika e shtetit komunist për hapjen e tokave bujqësore edhe në zonat malore çoi në shkatërrimin e shumë pyjeve me vlerë. Duke qenë të papërshtatshme për kulturat bujqësore, shumica e tyre u braktisën pas vetëm një apo dy vjetësh. Shumë prej pyjeve private u shkatërruan si pasojë e kësaj politike, kryesisht pranë qendrave të banuara. Aktualisht, këto toka janë nga më të degraduarat si pasojë e mbi shfrytëzimit dhe mbikullotjes kombinuar me zjarret e shpeshta. [MOAF, 1998]
- <sup>11</sup> Agjencia për Pyjet lidhet me të gjithë pyjet shtetërorë dhe privatë. Ajo duhet të jetë një institucion pyjor publik dhe i pavarur nën autoritetin e ministrisë përkatëse (Nonic, Milijic 2008).
- <sup>12</sup> Një studim mbi NVM në bashkinë Majdanpek në Serbinë Verilindore që përfshiu pronarë/menaxherë të 9 NVM theksoi se aktivitetet bazë të tyre janë prerja dhe transporti i materialit asortimenteve drusore, ndertimi i rrugëve dhe pistave pyjore, si dhe prodhimi i qymyr drurit për tre dhe prodhimi i kompensatës në një rast, (FORNET 2009).
- <sup>13</sup> Një shembull tipik është Dhoma e Tregtisë me degë të saj. Të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat, për shembull për punë druri, merrnin pjesë në këto organizata në të kaluarën. Sot pothuajse të gjitha njësive të prodhimit janë private. Megjithatë, struktura e domos ka mbetur pothuajse tërësisht e pandryshuar dhe ajo vazhdon të sigurojë shërbime për pak ndërmarrje shtetërore të mbetura. (Nonic, Milijic 2008).
- <sup>14</sup> Shih për më shumë detaje në linjat e kreditit të donatorëve në Maqedoni—Ministria e Ekonomisë 2008.

## REFERENCA

Beguš, J. (2006): Report of International Consultant for Capacity Development of Public Forest Service and Private Forest Owners' Associations. FAO/GCP/FRY/003/FIN Project "Forest Sector development in Serbia," [www.forestryprojectserbia.org](http://www.forestryprojectserbia.org), Belgrade.

Center for Research and Policy Making; Center for Research and Policy Making, CPRM Team; Project Co-ordination, European Commission, Austrian Institute for SME (2008): Overview of Family Business relevant Issues—Macedonia.

Danilović M. (2008): "Exploitation of private owned forests" educational project by MAFWP Directorate for forests, Faculty of Forestry, University of Belgrade.

European Forest Institute (EFI) (2007): The forest map of Europe. [http://www.efi.int/portal/virtual\\_library/information\\_services/mapping\\_services/forest\\_map\\_of\\_europe/](http://www.efi.int/portal/virtual_library/information_services/mapping_services/forest_map_of_europe/).

Fornet Ltd. (2009.): "Forest-based companies, their roles and their potential to contribute to the economic development of the municipality of Majdanpek"—Feasibility study—GTZ-KWD project "Economic development of municipalities in the Danube region."

Lako, T. (2008): Status quo analysis—Analyses of communal and private forestry in Albania and their role in the National Forest Strategy process. World Bank—Profor, Confederation of European Forest Owners, Lovre print, Sopron, 81.

Ministerial Conference on the Protection of Forests in Europe (MCPFE), Liaison Unit Warsaw (2007): State of Europe's forests 2007—The MCPFE report on sustainable forest management in Europe. Warsaw

Medarevic, M., Bankovic, S. 2008. Forests of Serbia Today. Forests No. 100, Srbijasume, Belgrade, 6–11.

Nicholson K., Radosavljevic A., Zaric V (2006.): "Report of mission on development of small and medium sized forest-based enterprises"—Preliminary Planning Phase and Phase 1 of Market Analysis and Development (MA&D) FAO Project GCP/FRY/003/FIN "Forest Sector Development in Serbia."

Nonic, D., (2004): Organization of Forestry in Transition: Relations of State Forestry Institutions and Private Forest Owners. Doctorate dissertation, Faculty of Forestry, Belgrade, 232.

Nonic, D., Herbst, P. (2005): Fragen des Privatwaldsektors in Serbien. Forstzeitung 7, Österreichischer Agrarverlag, Wien, 32–33.

Nonic, D., Milijic, V. (2008): Status quo analysis: Private Forestry in Serbia and its Role in NFP/NFS process. World Bank—Profor, Confederation of European Forest Owners, Lover print, Sopron, 95.

Nonic, D., Tomic, N, Markovic, J., Herbst, P., Krajcic, D. (2006): Organization of private forest owners in Serbia compared to Austria, Slovenia and other Central European countries. Forstwissenschaftliche Beiträge Forstpolitik und Forstökonomie, Nr. 35; ETH, Zürich, 95–106.

Private Forest Owners' Associations Formation in the Western Balkans (PRIFORT) research project unpublished research documentation (2009). In Glück, P. et al. (2009): The Preconditions for the Formation of Private Forest Owners' Interest Associations in the Western Balkan Region.

Radosavljević A., Kisin B., Kaurin R. (2008.): "Final Report" of FAO Project GCP/FRY/003/FIN "Forest Sector Development in Serbia."

Radosavljevic A., Fransen A., Balic A. (2009.): "Forest related SME's analysis and training in Montenegro—first stage report" SNV Forestry sector programme support to Montenegro.

Radosavljević T. (2008): "Marketing Basic: Marketing of non wood forest products," diploma work, Faculty of Forestry, University of Belgrade.

Ranković, N. and Nonić, D. (eds.). (2002): Privatization in Forestry. Volumes I and II. Faculty of Forestry of the Belgrade University, Serbia, Belgrade.

Savik, N. (2009): Analyzes of the competitiveness of forest industry in the Republic of Macedonia, Master Thesis (FOPER), Belgrade, Serbia.

Schmithüsen F., Kaiser, B., Schmidhauser, A., Mellinghoff, St., Kammerhofer, A. W. (2006): Preduzetništvo u šumarstvu i drvnoj industriji-osnove menadžmeta i poslovanja. Centar za izdavačku delatnost Ekonomskog fakulteta u Beogradu.

Serbian Agency for the Development of SME and Entrepreneurship (2008.): "Annual Working Report for 2007."

Statistical Yearbook of the Republic of Macedonia (2004): Forestry; State Statistical Office of the Republic of Macedonia.

The Forest Dialogue (TFD) (2009): Investing in Locally Controlled Forestry: Improving Quality and Quantity. Concept paper. [http://environment.yale.edu/tfd/uploads/ILCF\\_Concept\\_Paper-2009.pdf](http://environment.yale.edu/tfd/uploads/ILCF_Concept_Paper-2009.pdf)

Trendafilov, A., Atanasovska, J.R., Simovski, B. (2008): Status quo analysis—Analysis of private forestry in Macedonia and its role in the National Forest Strategy process. World Bank—Profor, Confederation of European Forest Owners, Lover print, Sopron, 83.

*The work of The Forests Dialogue is implemented by a Secretariat hosted by the School of Forestry and Environmental Studies (F&ES) at Yale University in the United States. TFD is an autonomous program composed of individuals and governed by a Steering Committee with representatives from major forest stakeholder groups. The statements, reports, and findings of TFD do not necessarily represent the views of F&ES faculty.*

*All inquiries should be directed to Gary Dunning at TFD: [info@theforestdialogue.org](mailto:info@theforestdialogue.org).*